

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7874 E hënë 6 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Të prekurit përfshijnë Këshillin e BE-së, i drejtuar aktualisht nga Donald Tusk, Komisionin e BE-së, i kryesuar nga Zhan-Klod Junker; presidenca dhe një pjesë e bordit të...

Vijon në faqen 20

Nga BRUNELLO ROSA

“Zilja e fundit” për integrimin në BE



Opinion **Ditës**

Krahës përgjysmimit të tarifave shkollore, pakti për universitetin u mundësoi në prill 48 studentëve të ekonomisë, të porsadiplomuar nga universitetet shtetërore...

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Pakti i munguar për punën



PS mbledh në 8 dhe 10 maj, kryesinë dhe asamblenë

Lista, 30 kandidatët e konfirmuar të PS për kryetar bashkie, Durrësi i paqartë

Përballja e koalicioneve në shifra, ja sa vota kanë secili...

Partia Socialiste do të përcaktojë këtë javë 61 kandidatët e saj për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillave bashkiakë. Për këtë ajo do të mbledhë dhe dy nga forumet e saja më të larta vendimmarrëse siç është asambleja kombëtare dhe kryesia. Kështu, në datën 8 maj është përcaktuar të mblidhet kryesia e cila do bëjë dhe përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie edhe në...

Në faqen 5

VENDIMI I QEVERISE: INDEKSIMI 2.8 PER QIND, SA SHKON PERLLOGARITJA E TYRE

RRITEN PENSIONET PER 665 MIJE TE MOSHUAR

Cilat janë kategoritë që do të marrin më shumë para dhe vlera e pensionit minimal dhe maksimal. Rastet konkrete dhe ndryshimet



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 9

TE NDARE NE 5 MAJ

Basha: Për lirinë betejë çdo ditë, Rama: Forcat që pengojnë negociatat

Në faqet 2-3

AGJENCIA E KADASTRES

Ndërtimet pa leje, lista e dytë me 1000 përfituesit që legalizohen

Në faqen 19

INTERVISTA

Kreu i Shoqatës së të Verbërve: Ulen pagesat për aftësinë e kufizuar

Në faqen 8

DEKLARATA

Vizita e Vuçiq me Ramën në Tiranë Vetëvendosja: E presim me protesta!

Në faqen 12

FUSHE-KRUJE



Vrau 10-vjeçarin, “monstra” Zizi i vë zjarrin qelisë së burgut

Në faqen 6

Mjeku popullor: Kujdes, bima nuk duhet përdorur nga të sëmurët me kolit

Ylli Merja: Efektet e dranakuqit në trupin tuaj

Mjeku Sotiraq Lako: “Holluesit e gjakut”, funksioni real në organizëm

Nga VOLTIZA DURO

Bima e dranakuqit e njohur ndryshe me emrin Rhamnus frangula L, është një shkurre e përhapur në Shqipëri dhe rritet në toka argjilore-silicore, zakonisht në pyje me lagështi. Për përdorim mjekësor mblidhen lë-



voret e tringut dhe të degëve në periudhën e pranverës. Bima e dranakuqit duhet tharë në hije dhe në vend me temperature të lartë, që të nxitet prodhimi i përbërësve kimikë që forcojnë efektin e bimës. Bima e dranakuqit përmban glikozide...

Suplement

DITA E DËSHMORËVE HOMAZHET

Klasa politike e ndarë në Ditën e Dëshmorëve, tri ceremoni të ndryshme

Basha: Për lirinë shkohet në betejë çdo ditë, të bashkuar para tiranisë

Meta: Në Europë përmes dialogut dhe bashkëpunimit

Klasa politike shqiptare u shfaq edhe një herë dhe e ndarë sa i përket nderimit të historisë dhe kontributit të atyre që kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre për të patur një Shqipëri të lirë. Ashtu si edhe për datën e çlirimit të vendit edhe në 5 Maj, Ditën e Dëshmorëve, palët politike në vend, megjithëse nuk kanë dallime për njohjen e saj, e kujtuan atë të ndarë në tri ceremoni të ndryshme. Një ceremoni e organizuar nga Protokolli Shtetëror në varrezat "Dëshmorët e Atdheut" dhe ku merrnin pjesë Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama, një tjetër e organizuar nga Partia Demokratike po në varrezat "Dëshmorët e Atdheut" dhe një tjetër e organizuar nga LSI pranë bustit të Qemal Stafës.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, duke vendosur kurora në Varrezat e Dëshmorëve

MESAZHI

"Është një ditë nderimi, respekti, mirënjohjeje e thellë kombëtare, patriotike dhe individuale, ndaj qindra, mijëra burrave dhe grave, të rinjve dhe të reja që flijuan jetën e tyre në altarin e lirisë kombëtare. Është po kështu një ditë reflektimi, për t'u bashkuar të gjithë sërisht për të mbrojtur lirinë dhe vlerat e saj, të vetdijshëm se për lirinë shkohet në betejë çdo ditë", tha Basha.

LSI: Rama rivrau të rënët me nderimin e Mithat Frashërit

Ndryshe nga qeveria dhe Partia Demokratike që bën homazhe në Varrezat e Dëshmorëve, Lëvizja Socialiste për Integrim zgjodhi pikërisht bustin e Qemal Stafës për të shprehur mirënjohjen dhe për të respektuar kontributin dhe sakrificën e të rënëve për çlirimin e vendit. Zëvendëskryetari i LSI-së Luan Rama, Nënkrjetarja e LSI-së Erisa Xhixho, ish-deputetët Klajda Gjoshja, Nora Malaj dhe të rinjtë e LRI-së vendosën kurora me lule pranë bustit të heroit Qemal Stafa, i cili u vra pikërisht në 5 maj 1942, duke shënuar kështu 77-vjetorin e



ndarjes nga jeta. Pas vendosjes së buqetave me lule, në fjalën e rastit, zëvendëskryetari i LSI-së theksoi se 5 Maji është një ditë e shenjtë e nderimit të dëshmorëve të luftës Antifashiste-Nacional Çlirimtare. "Është një ditë mesazhi, pasi

amaneti i gjakut, është amaneti më i shenjtë i një populli. Aq më tepër në kontekstin e zhvillimeve në të cilat gjendet Shqipëria e sotme, përkundër hipokrizisë së një pushteti dhe të një Kryeministri, i cili jargavitet pas kufomave të bashkëpunëtorëve të fashizmit të Luftës së Dytë Botërore. Dhe pas atyre që për turpin e tyre zgjodhën të bëhen me humbës të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Kjo hipokrizi shfaqet edhe sot duke i rivrarë të rënët në luftë, me nderimin për pinjollët dhe bashkëpunëtorët e fashizmit që prej Mithat Frashërit dhe të gjithë të tjerëve", - tha Luan Rama.

identit Meta i përcolli edhe një mesazh politikës shqiptare ku kërkoi reflektim përmes dialogut politik, si e vetmja rrugë që të çon drejt së ardhmes. "Sot është edhe ditë reflektimi për të vendosur në plan të parë interesat e vendit, të së ardhmes së tij europiane, të stabilitetit përmes dialogut dhe bashkëpunimit, në mënyrë që ëndrrat e tyre të realizohen plotësisht dhe

që të nderojmë vërtet ashtu siç duhet kujtimin e të gjithë atyre, të cilët kanë bërë sakrificat më të mëdha, më sublimë, për të ardhmen e Shqipërisë", - tha Meta.

OPOZITA

Rreth një orë më pas në Varrezat Dëshmorëve kanë mbërritur përfaqësuesit e Partisë Demokratike, ku kryedemokrati Lulzim Basha, ish-kryeministri Sali

Berisha dhe shumë figura të tjera të demokratëve kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule në nderim të të rënëve për lirinë e vendit. Duke folur për mediat pas kësaj ceremonie, kryedemokrati Lulzim Basha theksoi se sakrificat dhe kontributi i të rënëve dëshmorë duhet t'i shërbejë çdo shqiptari për të kuptuar se për lirinë ia vlen të lufto-



Gjatë ceremonisë së djeshme me rastin e 5 Majit

Kryemadhi: Amaneti i dëshmorëve frymëzim për ditët e sotme

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi zgjodhi që mesazhin e saj me rastin e 5 Majit ta përcjellë nëpërmjet rrjeteve sociale. Në një status të sajën ajo theksoi se jetën e flijuar gjatë luftës duhet ti frymëzojnë edhe sot shqiptarët për ta mbajtur të shenjtë amanetin për Shqipërinë e lirë. "Në 5 maj i gjithë Atdheu mban frymën në respekt të pafund për të rënët për atdheun, martirët e kombit që sakrifikuan jetën e tyre e në emër të Shqipërisë. Lufta për çlirimin e atdheut gjaku i derdhur, jetën e flijuar dhe sakrificat sublimë për lirinë e tij, janë gdhendur si dëshmia monumentale e një populli që ka luftuar në mënyrë të paepur me pushtuesit gjatë gjithë historisë së tij. Nderimi ndaj dëshmorëve, është nderim për historinë e popullit, por është edhe një referencë krenarie, që na frymëzon për ta mbajtur të shenjtë amanetin e tyre. Shqipërinë e lirë, shtëpinë tonë të përbashkët! Lavdi e përjetshme dëshmorëve të atdheut!", - shkroi Kryemadhi.



5 Maji, komunistët nderime me fotot e ish-diktatorit

Ashtu siç e kanë kthyer në një traditë tashmë, nostalgjikë të ish-diktatorit Enver Hoxha dhe përfaqësues të Partisë Komuniste kanë nderuar dhe më 5 Maj të rënët e luftës Nacionalçlirimtare në Varrezat e Dëshmorëve. Me fotot e ish-diktatorit, Enver Hoxha, me grusht, banderola dhe yllin me pesë cepa, ata kanë vendosur kurora me lule në monumentin "Nënë Shqipëri". Ata bën homazhe vetëm pak kohë pasi nga Varrezat e Dëshmorëve ishin larguar përfaqësuesit e Partisë Demokratike. Kjo nuk është hera e parë që ithtarët e ish-diktatorit provokojnë me nderime të tilla duke bërë shkak për reagime të herëpashershme të demokratëve dhe të djathtës në përgjithësi.

het çdo ditë. "Është një ditë reflektimi, për t'u bashkuar të gjithë sërisht për të mbrojtur lirinë dhe vlerat e saj, të vetdijshëm se për lirinë shkohet në betejë çdo ditë. Sot është po kështu një ditë që secili prej nesh të ndjehet në shpirt dhe mbi supeteshën e rëndë të sakrificës që ky komb ka paguar për liri e bashkë me të edhe bekimin e Zotit për të bërë gjithçka për

ta mbrojtur atë me çdo kusht, para çdo tiranie, para çdo tirani", - tha në fjalën e tij Basha. Më pas përfaqësuesit e PD-së bën homazhe edhe pranë vendit ku prehet Heroi i Demokracisë, Azem Hajdari si dhe në vendin ku prehen 22 intelektualët e pushkatar nga regjimi komunist, të akuzuar për hedhjen e bombës në ambasaden sovjetike.



Kreu i qeverisë kërkoi të ndahet vlerësimi për luftën me atë që solli paslufta

Rama: Ceremoninë për nder të Mithat Frashërit do e bëja sërish

"Një forcë e brendshme kërkon pengimin e negociatave"

Kryeministri Edi Rama nuk është bërë aspak pishman për ceremoninë që organizoi në nderim të Mithat Frashërit me rastin e ardhjes dhe rivarrosjes së eshtrave të tij disa muaj më parë. Në Ditën e Dëshmorëve dhe para dhjetëra veteranëve të LANCC, kreu i qeverisë ka theksuar se do ta bënte sërish atë ceremoni, ndërsa kërkoi nga veteranët e luftës dhe ish-partizanët që ta vlerësojnë historinë me objektivitet dhe jo me emocion. "Unë do ta bëja prapë, edhe një herë, njësoj, ceremoninë për Mithat Frashërin, që të jemi të qartë. Jo sepse unë kam ndonjë dilemë. Nuk kam dilemë lidhur me kufirin që ndan qartësisht patriotët nga bashkëpunëtorët e nazizmit, por sepse unë nuk i besoj historisë së shkruar nga fitimtarët", - tha kryeministri Rama. Më tej ai theksoi se nuk do të ishte e pranueshme që historia të vlerësohej nga pozicione të njëanshme dhe aq më pak duke konsideruar armik këdo që ka menduar ndryshe, pavarësisht se qëllimi ka qenë i njëjtë, çlirimi i vendit. "Më lejoni t'ju them vetëm një gjë, nuk e vlerësojmë si duhet luftën antifashiste, nuk e vlerësojmë si duhet gjakun e dëshmorëve, nëse i hyjmë në hak kujtdo që ka qenë në një pozicion të ndryshëm dhe ka synuar të njëjtën gjë, çlirimin e vendit nga okupatorët e huaj", - theksoi kreu i qeverisë. Nga ana tjetër ai ka prekur edhe çështjen e Institutit të Studimeve të Krimeve të Komunistit që drejtohet nga Agron Tufa duke theksuar se i takon Kuvendit të Shqipërisë të bëjë vlerësimet për të. "Çfarë ndodhi e si ndodhi në pikëpamje të luftës për çlirim deri në 29 nëntor të vitit 1944 nuk mund të jetë kurrë objekt i një instituti që paguhet nga taksat e shqiptarëve. Çfarë erdhi pas, ka qenë objekt i punës së atij instituti e i takon Kuvendit të Shqipërisë të bëjë të gjitha vlerësimet e nevojshme, në raport me ligjin, apo me shkeljen e ligjit, në raport me dobinë, apo me dëmin e shkakuar nga një i tillë institut", - u shpreh Rama.



Kryeministri Edi Rama, gjatë takimit me veteranët

INSTITUTI
"Dua ta nënvizoj shumë qartë se për mua ka një vijë ndarëse midis luftës dhe historiografisë së pasluftës. Janë dy gjëra të ndryshme dhe do doja që asnjëherë të mos ngatërrojm atë që buron nga gjaku i pastër i dëshmorëve të luftës antifashiste me atë që buron nga gjakderdhja e gjakut të pafajshëm të pasluftës për shkak të një regjimi diktatorial. Ajo që prodhoi paslufta nuk mund të thuhet se ishte ana e duhur e historisë."

Bashkia e Tiranës nderon Organizatën e Dëshmorëve të LANÇ

Bashkia e Tiranës nderoi sakrificën e bërë nga gjithë ata të rinj dhe të reja që në momentet më të vështira dhe kritike për të ardhmen e vendit tonë u ngritën dhe luftuan kundër pushtuesit nazifashist. Me rastin e 5 Majit, Ditës së Dëshmorëve që këtë vit shënon edhe 75-vjetorin e çlirimit të Shqipërisë, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj i dorëzoi sot titullin e nderit "Simbol i qytetit të Tiranës" Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut - Dega Tiranë. Në fjalën e tij ai vlerësoi rolin që ka luajtur kjo organizatë në promovimin e vlerave patriotike dhe sakrificave vetëmohuese të gjithë atyre që luftuan dhe dhanë jetën për të patur një Shqipëri të lirë. "Ashtu siç nderojmë personalitete të huaja, nderojmë dhe ruajmë një vend të veçantë për të gjithë ata që kontribuojnë çdo ditë që Tiranë dhe Shqipëria të jetë më e mirë. Bashkia e Tiranës ka vendosur që të akordojë titullin "Simbol i qytetit të Tiranës", në Ditën e Dëshmorëve, Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve të LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë, dega Tiranë, me motivacionin "Për veprimtarinë e saj të vazhdueshme në hulumtimin, ruajtjen dhe promovimin e vlerave patriotike dhe historike të veprave dhe sakrificave vetëmohuese të të rënëve për pavarësinë, lirinë e atdheut dhe mbrojtjen e rendit publik. Veprimtaria e saj e vazhdueshme e ka shndërruar këtë organizatë në simbol të qytetit për vlerat që ajo pasqyron", - tha Veliaj.

Ruçi: Partizanët dëshmorë janë legjion nderi i kombit

Për të përkujtuar 5 Majin dhe nderuar dëshmorët e atdheut, Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, bëri paraditen e djeshme homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në qytetin e Fierit. I shoqëruar nga pjesëtarë dhe të afërm të familjeve të dëshmorëve, veteranë të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare dhe pasardhës të tyre, deputetë dhe drejtues të pushtetit vendor të qarkut Fier si edhe qytetarë të shumtë, Kryetari i Kuvendit vendosi një kurorë me mbishkrimin "Lavdi të përvetshme dëshmorëve të atdheut". "Dëshmorët janë çmimi i Lirisë së atdheut tonë të dashur. Shqipërisë, e cila i ka rrënjët në sakrificat e të rënëve gjatë gjithë historisë së saj. Prandaj, qëndrimi ndaj dëshmorëve të atdheut nuk është një çështje morale apo edukimi, por një çështje themelore e identitetit tonë kombëtar. Dëshmorët nuk u takojnë partive, por Shqipërisë. Partitë tregojnë emancipimin e tyre, kur ndërojnë dëshmorët. Partizanët dëshmorë, të rënë gjatë Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, janë një legjion nderi i kombit shqiptar, me të cilët shqiptarët janë krenuar, krenohen dhe do të krenohen përjetësisht", - tha Ruçi.

Veteranët e LANÇ kundër qeverisë: Favorizon kolaboracionistët

Dita e Dëshmorëve ka ndarë dje jo vetëm politikën, por edhe ata që ishin protagonistë të ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore apo pasuesve të tyre. Nga dreka e përvitshme që socialistët shtrugojnë çdo 5 maj në nder të veteranëve të luftës dhe sakrificës së dëshmorëve të rënë, përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës nuk nguruan të shprehin pakënaqësitë e tyre edhe ndaj qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama lidhur me qëndrimet që ka mbajtur ndaj balistëve dhe nacionalistëve dhe rolit të tyre në luftë. Duke iu referuar pikërisht ceremonisë që organizoi qeveria me rastin e rivarrosjes së eshtrave të Mithat Frashërit ata nuk nguruan ta konsiderojnë këtë si një lëshim që qeveria u ka bërë kolaboracion-



istëve. "Mos t'u gënjejë mendja se nga ato lëshimet që iu bëri qeveria me ceremoninë që organizoi për kolaboracionistin Mithat Frashëri apo duke mbajtur një institut famëkeq të krijuar nga Sali Berisha me në krye disa neoballistë që krijuan pavarure denigruese për luftën antifashiste dhe dëshmorët e saj, apo duke u frymëzuar nga veprimtaria destruktive dhe antishqiptare e opozitës e sotme do të mund të rehabilitojnë tradhtinë e

sotme dhe të djeshme", - tha Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ. Më tej ai në emër edhe të veteranëve dhe të tjerë dhe familjarëve të dëshmorëve bëri të ditur se nuk do lejojnë që neoballistët dhe neozogjistët të përdhosin Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare. "Ata do të dëshmojnë me turp ashtu si ballarët dhe gjyshërit e tyre dje në luftë të cilët për tradhtinë e tyre përfunduan në koshin e plehrave të historisë nga i cili skano për të dalë kur, ashtu do të pësojnë dhe pinjollët e tyre sot", - tha ai. Ndërkohë që Dalan Buxheli, sekretar i kësaj organizate shprehu kritikë ndaj qeverisë edhe në aspektin e trajtimit financiar të veteranëve dhe kryesisht të familjarëve të dëshmorëve.

atë që buron nga gjaku i pastër i dëshmorëve të luftës antifashiste me atë që buron nga gjakderdhja e gjakut të pafajshëm të pasluftës për shkak të një regjimi diktatorial. Ajo që prodhoi paslufta nuk mund të thuhet se ishte ana e duhur e historisë", - nënvizoi Rama.

INTEGRIMI
Në fjalën e tij kreu i qeverisë u ndal gjatë edhe te procesi i integrimit dhe përgjigja që pret të marrë Shqipëria në qershor për hapjen e negociatave. Duke theksuar se ky 75-vjetori i çlirimit të vendit

vjen në një moment kur vendi pret t'i çelë rruga për negociatat për anëtarësim në BE, ai nuk la pa theksuar se forca të brendshme po punojnë kundër interesave të Shqipërisë. "Unë e dëshiroj me gjithë zemër që këtë përpjekje të gjatë dhe të vështirë, ku për fat të keq nuk kemi qenë të gjithë të bashkuar, por si askund tjetër në vendet që kanë synuar çeljen e negociatave dhe që sot janë në proces negociimi, apo janë anëtarë të Bashkimit Europian, një forcë e brendshme është përpjekur dhe përpigjet çdo

ditë të pengojë çeljen e negociatave, duke e kthyer këtë aspiratë kombëtare e këtë objekt kombëtar në një argument të politikës së ditës", - tha Rama. duke komentuar edhe debatin që shoqëroi Samitin e Berlinit, kreu i qeverisë theksoi se ajo që vlerëson detyrat e realizuara nga qeveria shqiptare është Komisioni Europian në rekomandimin që do t'i bëjë kështillit. Në këtë aspekt ai theksoi se vendimi që vjen më pas nga shtetet e ndryshme është produkt i zhvillimeve të tyre të brendshme.

KRIZA PRESIDENTI

Kreu i shtetit uroi besimtarët myslimanë me rastin e nisjes së muajit të Ramazanit

Ilir Meta: Të zgjatim dorën e bashkëpunimit e të gjejmë zgjidhjen

"Të bashkuar ne duhet dhe mund t'ia dalim"

Kreu i Shtetit, Ilir Meta ka përcjellë dje një mesazh për gjithë besimtarët myslimanë me rastin e nisjes së muajit të shenjtë të Ramazanit. Në urimin e tij Presidenti i Republikës theksoi se në këtë muaj njeriu tregon sakrificën e tij ndaj Zotit, por edhe shoqërisë dhe kombit. "Nga zemra u uroj ju dhe mbarë popullit, Gëzuar Muajin e Bekuar të Ramazanit, muajin e sakrificës e të reflektimit, por edhe të dhënies së provave të pafundme të forcës së besimit në Zot! Agjërim të lehtë, të shëndetshëm dhe të pranuar, mbarësi dhe begati në familjet tuaja dhe Zoti ju ndihmoftë për ta përbushur atë më së miri!", - shprehet kreu i shtetit në mesazhin e tij. Më tej ai nënvizon se ky muaj duhet ti bëjë gjithë më të mirë dhe të kthejë paqen e kohezionin social mes shqiptarëve.



Presidenti Ilir Meta

MESAZHI

"Le të shërbejë ky Muaj, si mesazh i qartë, se bashkërisht duhet të përpiqemi dhe pavarësisht sakrificave që kërkohen, të afrojmë më shumë zemrat tona, të zgjatim dorën e bashkëpunimit dhe të unifikojmë shqetësimet e të gjejmë zgjidhjen e tyre. Vendi ka nevojë për shpresë dhe të bashkuar ne duhet dhe mund t'ia dalim!"

Kryemadhi: Jemi shumicë, protesta deri sa të bindet sulltani i krimit

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi është e bindur se opozita dhe ata që janë kundër qeverisë aktuale përbëjnë shumicën e shqiptarëve. Nëpërmjet një mesazhi në rrjetet sociale, Kryemadhi thekson se pavarësisht sondazheve, shumica e shqiptarëve janë në rrugë dhe kërkojnë largimin e qeverisë. "Me sondazhe dhe pa sondazhe, ne jemi shumicë. Sepse në njërin anë është një njeri me grusht kriminelësh dhe oligarkësh dhe disa kërpudha që janë kthyer në fasada të tij. Dhe në anën tjetër janë shumica e shqiptarëve që duan integritimin e Shqipërisë. Dhe sot shumica është opozita e bashkuar dhe jo vetëm, por me të gjithë ata shqiptarë, të cilët



duhet të bashkohen dhe të rrezojnë këtë regjim kriminal", - shkroi Kryemadhi. Ndaj ajo thekson se për shkak se qeverisja aktuale jo vetëm që nuk është më shumicë, por edhe po varfëron gjithnjë e më shumë shqiptarët, opozita është e vendosur që t'i vazhdojë protestat e saj. "Protestat tona dhe mosbindja civile do të vazhdojnë derisa sulltani i krimit të bindet me

hir a me pahir se në Shqipëri do apo nuk do ai, do të ketë zgjedhje të lira dhe të ndershme për shqiptarët. Koha e tij dhe e etërve të tij ka mbaruar në Shqipëri", - shkroi Kryemadhi. Opozita ka paralajmëruar në datë 11 maj një protestë tjetër të madhe, ku ka ftuar në Tiranë të gjithë shqiptarët që janë të pakënaqur nga qeveria.

është e prekur nga krimi, droga, bixhozi e fajdetë, largimi nga arsimi e edukimi cilësor, papunësia dhe fenomenet e tjera negative. Në këtë Muaj të shenjtë, të reflektojmë për të bërë ç'është e mundur, për pastrimin shpirtëror, moral e social të rinisë sonë dhe për forcimin e shtyllës më të fortë të shoqërisë, familjes", - shkruan

Meta në urimin e tij. Gjithashtu Meta në fund të mesazhit të tij e vë theksin se muajit të Ramazanit duhet i shërbejë edhe politikës që të zgjasë dorën e bashkëpunimit dhe të gjejë zgjidhje për shqetësimet që shoqërojnë sot gjithë shoqërinë shqiptare. Vetëm të bashkuar thekson Kreu i Shtetit, Shqipëria mund t'ia dalë. "Kemi

nevojë, dhe agjërimi e jep këtë mundësi, të pendohejmë për gabimet tona e t'i kërkojmë falje Zotit për gjithçka, duke u përmirësuar në funksion të përqafimit të vlerave më të mira hyjnore e humane që na mundësojnë një të ardhme më të begatë, në familjen europiane. Le të shërbejë ky Muaj, si mesazh i qartë, se bashkë-



Patozi: PD po kërkon qenin e ngordhur të fletët e firmave tuaja

Themeluesi i Partisë Bindja Demokratike, Astrit Patozi ka përcjellë dje një falënderim të veçantë për të gjithë ata që i janë bashkuar kësaj nisme politike gjatë këtyre ditëve, ndërsa ka shprehur keqardhje për të gjithë ato forca politike që, sipas tij, janë përpjekur që ta denigrojnë atë. "Përcimin dhe neveri për të gjithë ata, që u përpoqën pa sukses për të bërë pis vullnetin tuaj, duke shpikur një gjueti të pashembullt shtrigash me akuza të fabrikuara dhe me falsifikime në çdo cep të Shqipërisë. Edhe vrasësit apo trafikantët e drogës nuk janë përndjekur në këtë vend ashtu si ju këto ditë, dhe kjo e bën më të mjerë pozitën e atyre që e urdhëruan këtë poshtërsi morale, politike dhe njerëzore", - shkroi Patozi në mesazhin e tij. Më tej ai nënvizon se koha do ta tregojë se ata që firmosën për Bindjen Demokratike janë në krahun e duhur të historisë, ndërsa ata që sipas tij u përpoqën më të përdhoshin dëshirën e këtyre firmëtarëve "do t'u ngelet vetëm turpi për atë akt të pashembullt dhe tinëzër pabesie". Gjithashtu, Patozi shpreh besimin se Bindja Demokratike do të tregojë që në zgjedhjet e ardhshme vendore se nuk ishte rastësi dhe se përfaqëson të gjithë ata shqiptarë që janë të lodhur nga politika e partive tradicionale. "Neshe do të tregojmë, qysh në këto zgjedhje, se nuk ishte aspak rastësi, që ju u përgjigjet aq shpejt për t'i dhënë jetë një projekti të pastër politik për Shqipërinë, i cili i ka tronditur kaq fort gardianët e sistemit të kalbur, që ende janë duke kërkuar qenin e ngordhur tek fletët e firmave tuaja të hedhura me gjithë zemër nga e gjithë Shqipëria", - shkroi kryetari i Bindjes Demokratike.



isht duhet të përpiqemi dhe pavarësisht sakrificave që kërkohen, të afrojmë më shumë zemrat tona, të zgjatim dorën e bashkëpunimit dhe të unifikojmë shqetësimet e të gjejmë zgjidhjen e tyre. Vendi ka nevojë për shpresë dhe të bashkuar ne duhet dhe mund t'ia dalim!", - mbyll mesazhin e tij Presidenti i Republikës, Ilir Meta. Ai është

të angazhuar ditët e fundit në disa përpjekje për të afruar palët politike drejt një zgjidhje për krizën politike që po kalon vendi. Për këtë ai priti në një takim edhe kryetarët e disa partive opozitare, ku u evidentua nevoja e një tryeze bisedimesh me pjesëmarrjen e dy liderëve politikë, atij të mazhorancës dhe atij të opozitës.



PS mbledh në 8 dhe 10 maj kryesinë dhe asamblenë për të miratuar emrat

30 kandidatët e konfirmuar të PS për kryetar bashkie

Mbetet ende e paqartë kush do jetë kandidat në Durrës

Partia Socialiste do të përcaktojë këtë javë 61 kandidatët e saj për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillave bashkiakë. Për këtë ajo do të mbledhë dhe dy nga forumet e saja më të larta vendimarrëse siç është asambleja kombëtare dhe kryesia. Kështu, në datën 8 maj është përcaktuar të mbledhet kryesia e cila do bëjë dhe përzgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie edhe në ato qytete ku ky proces nuk është mbyllur ende. Më pas në datën 10 maj, pra 1 ditë para se opozita të mbajë protestën e saj të radhës kombëtare, do të mbledhë asamblenë kombëtare për të miratuar edhe aty listën e plotë të kandidatëve.

KANDIDATËT

Deri më tani procesi i përzgjedhjes së kandidatëve ka përfunduar në 30 bashki, ku nuk ka më dilema për kandidatët që do përfaqësojnë siglën e PS-së si dhe koalicionin që ajo ka formuar për këto zgjedhje. Kështu, përveç kandidatëve të konfirmuar edhe publikisht dhe të prezantuar edhe gjatë kongresit të marsit, Erion Veliaj në Tiranë, Armando Subashi në Fier, Gledian Llatja në Elbasan, Dritan Leli në Vlorë dhe Pjerin Ndreu në Lezhë, mund të konsiderohet i mbyllur procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për kryetar bashkie edhe në 25 bashki të tjera. Më konkretisht në Qarkun e Tiranës është i sigurtë tashmë kandidimi i Rakip Sulit në Kamzë dhe Arben Rugias në Kavajë. Ndërkohë në Berat është konfirmuar tashmë kandidimi i ish-zëvendësministrit të Arsimit, Ervin Demo. Kujtojmë se Demo u largua nga posti i zëvendësministrit, pas denoncimit publik të plagjiaturës me diplomën. Ndërkohë që po në të njëjtin qark është konfirmuar për një mandat të edhe kryetarja aktuale e Bashkisë së Urës Vajgurorë, Juliana Memaj. Burime nga PS bëjnë të sigurtë edhe kandidimi i Sybi Shehut në Bashkinë e Kuçovës, e cila deri më tani ashtu si edhe Bashkia e Beratit drejtohet nga LSI. Në Qarkun e Elbasanit përveç Gledian Llatjas, është konfirmuar edhe rikandidimi i Kastriot Gurrës në Bashkinë e Librazhdit, Arif Tafanit në Bels si dhe Nuri Belbës në Përrenjas. Ndërkohë

në Qarkun e Korçës, krahas Sotiraq Filos që rikandidon për një tjetër mandat në Bashkinë e Korçës, është konfirmuar edhe kandidimi i deputetit Ilir Xhakolli, i cili pak ditë më parë u prezantua publikisht nga Sekretari i Përgjithshëm i PS, Taulant Balla.

Në Qarkun e Shkodrës është përcaktuar më së fundi kandidati për bashkinë më të madhe të veriut. Kështu në Bashkinë e Shkodrës do kandidojë Valdrin Pjetri, ndërsa rikandidon Tonin Marinaj në Malësi të Madhe dhe Gjon Gjoni në Pikë. Në Bashkinë e Kukësit do të kandidojë Safet Gjici, ndërsa në atë të Tropojës Rexhë Byberaj. Në Bashkinë e Vlorës është rikandiduar Dritan Leli, ndërsa në atë të Himarës është rikandiduar Jorgo Goro. Mbetet ende e paqartë kandidatura për Bashkinë e Sarandës ku në balotazh deri më tani janë disa kandidatë. Në Gjirokastrë bëhet i sigurtë kandidimi i deputetit Flamur Golemi, ndërsa në Tepelenë do rikandidojë sërish Tërmet Peçi. Ndërkohë që në Bashkinë e Lezhës ka filluar tashmë fushatën Pjerin Ndreu, ndërsa në Mirditë Ndreu Deda. Ajo që mbetet ende me pikëpyetje është Bashkia e Durrësit, ku duket se moskandidimi i Vangjush Dakos tashmë është thuar se i sigurtë. Për zëvendësimin e tij kanë qarkulluar disa emra, mes të cilëve Arbër Braho, dy deputetë, Klodiana Spahiu dhe Milva Ekonomi. Përveç Durrësit mbeten ende të paqartë kandidatët edhe në 30 bashki të tjera.

SHKODRA

KANDIDATËT E KONFIRMUAR TË PS

- TIRANË ERJON VELIAJ
- KAMZË RAKIP SULI
- KAVAJË ARBEN RUGIA
- BERAT ERVIN DEMO
- KUÇOVË SYBI SHEHU
- URA VAJGURORË JULIANA MEMAJ
- ELBASAN GLEDIAN LLATJA
- BELSH ARIF TAFANI
- LIBRAZHDI KASTRIOT GURRA
- PËRRENJAS NURI BELBA
- FIER ARMANDO SUBASHI
- DIVJAKË FREDI KOKONESHI
- PATOS RAJMONDA BALILAJ
- ROSKOVEC MAJLINDA BUFI
- KORÇË SOTIRAQ FILO
- POGRADEC ILIR XHAKOLLI
- SHKODË VALDRIN PJETRI
- MALËSI E MADHE TONIN MARINAJ
- PUKË GJON GJONI
- KUKËS SAFET GJICI
- TROPOJË REXHË BYBERAJ
- VLORË DRITAN LELI
- KONISPOL SHUAIP BEQIRI
- HIMARË JORGO GORO
- GJIROKASTËR FLAMUR GOLEMI
- TEPELENË TËRMET PEÇI
- KRUIJË ARTUR BUSHI
- LEZHË PJERIN NDRËU
- MIRDITË NDREU DEDA

Përballja e koalicioneve në shifra, ja sa vota kanë secili

Në mungesë të një zgjidhje politike që mund të rifuste në zgjedhje edhe opozitën reale, atë që përfaqësohet nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, fati i zgjedhjeve vendore të 30 qershorit do të ishte i përcaktuar që më parë. PS së bashku me koalicionin e saj do kenë mundësi që të fitojnë të 61 bashkitë e vendit, duke krijuar kështu precedentin e parë kur një parti apo grupim politikë i fiton të gjitha. Dhe kjo se PS dhe koalicioni i saj është shumicë në popull, por se përballë në këto zgjedhje do ketë parti apo grupe partish inekzistente ose të dorës së dytë dhe të tretë, me peshe elektorale të pandjeshme. Kështu, PS ka siguruar të ketë në koalicion rreth 21 parti të tjera dhe që në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të shkuara lokale kanë një peshe elektorale rreth 565 mijë vota në total. Natyrisht që peshën kryesore brenda koalicionit e zë PS me mbi 400 mijë vota, ndërsa aleatët të gjithë kanë rreth 160 mijë vota. Ndërkohë që përballë koalicioni i PS-së ka një grupim të vogël partish që kanë formuar një koalicion opozitar të quajtur "Shpresa për Ndryshimin" dhe që në total të gjitha forcat që e përbëjnë atë kanë rreth 45 mijë vota. Ndërkohë që përveç këtij koalicioni në garë janë dhe rreth 13 parti të tjera që garojnë më vete dhe që gjithashtu janë parti të dorës së dytë apo të tretë, ndërsa disa prej tyre janë forca të reja dhe të paprovuara ndonjëherë në garë elektorale. Përmendim këtu rastin e Bindjes Demokratike apo Partinë Zgjidhja të Koço Kokëdhimës.

KOALICIONI ASE

- Partia Socialiste - 402.709 vota
- Partia Socialdemokrate e Shqipërisë - 22.320
- Partia Demokratia Sociale - 20.064 vota
- Partia Socialiste e Moderuar - 15.355 vota
- Aleanca Arbnore Kombëtare - 12.647 vota
- Aleanca Demokratike - 11.392 vota
- Partia e Çjellbër - 10.221 vota
- Partia Unitetit Kombëtar - 10.078 vota
- Partia G99 - 9.490 vota
- Partia Kristian Demokratike e Shqipërisë - 9.424 vota
- Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet - 9.008 vota
- Partia Ardhmëria Shqiptare - 7.314 vota
- Partia Demokratike e Re Europiane - 5.521 vota
- Partia e Reformave Demokratike Shqiptare - 3.957 vota
- Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian - 3.647 vota
- Partia e të Drejtave të Mihuara - 3.443 vota
- Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen - 3.144 vota
- Partia e Pajtimit Kombëtar - 2.526 vota
- Në total: 563,972 vota

KOALICIONI "SHPRESA PËR NDRYSHIMIN"

- Partia Balli Kombëtar - 14.137 vota
- Partia Bashkimi Liberal Demokrat - 12.949 vota
- Partia Ora e Shqipërisë - 10.745 vota
- Partia Demokratike e Re Europiane - 5.521
- Aleanca Popullore - 1.712 vota
- Aleanca Kuq e Zi
- Partia Emigracioni Shqiptar
- Në total: 45,064 vota

Ratkoceri: AKZ në zgjedhje pas thirrjeve të ndërkombëtarëve

Kryetarja e Aleancës Kuqezi, Lumturi Ratkoceri i ftuar në studion e lajmeve në "News 24" u shpreh dje se partia që ajo drejton do të jetë pjesë e zgjedhjeve lokale, që do mbahen këtë qershor, si pjesë e aleancës "Shpresa për ndryshim". Ratkoceri, në fjalën e saj nuk kurseu akuzat ndaj qeverisë aktuale, ndërsa u shpreh se këshilltarët e partisë që ajo përfaqëson nuk do të votojnë asnjëherë për kryebashkiakut të Tiranës, Erjon Veliaj. "Vendosëm momentin e fundit mbas thirrjeve të ndërkombëtarëve dhe dikush duhet të thoshte që boll



Kryetarja e Aleancës Kuqezi, Lumturi Ratkoceri

më nuk duhet të vazhdohet kështu. Një gjë është e sigurtë që Aleanca Kuqezi nuk do votojë asnjëherë Erion Veliajn. Këshilltarët tanë do të votojnë në të ardhmen vetëm për ato procese që janë në të mirën e qytetit. E

quaj të papranueshme që të bëhen bllokada për projekte që janë të mirën e vendit. Unë nuk kam parë një projekt që mund t'i sjellë të mirë qytetit, përveç biçikletave" - u shpreh Ratkoceri.



Helmimi i 93 personave në Bulqizë, mjeku: Dyshojmë te uji

Të paktën 93 persona dyshohet se u helmuan një ditë më parë nga uji i pijshëm në Bulqizë. Ata janë paraqitur në spital me të vjella, ndërkohë që drejtori i spitalit Hazi Jella e konfirmon një gjë të tillë për News 24. Sipas tij, të paktën 24 prej të shtruarve në spital

janë fëmijë. Jella thotë se s'mund të flasë për shkakun e helmimit, pasi janë ende në pritje të analizave. Paraprakisht dyshohet se situata mund të jetë shkaktuar nga uji i pijshëm. "Shkalla e helmimit, shkon nga e lehtë deri te ajo mesatare. Pacientët janë kryesisht nga

lagjia e vjetër e qytetit. Do të duhet të presim përgjigjen e analizave për të përcaktuar shkakun e këtij helmimi", - vijon mjeku. Rasti i helmimeve masive u publikua të shtunën, ku dhjetëra persona u paraqitën në spitalin e qytetit që prej mbrëmjes së të enjtes.

DYSHIMET

Të paktën 24 prej të shtruarve në spital janë fëmijë. Jella thotë se s'mund të flasë për shkakun e helmimit, pasi janë ende në pritje të analizave. Paraprakisht dyshohet se situata mund të jetë shkaktuar nga uji i pijshëm. "Shkalla e helmimit, shkon nga e lehtë deri te ajo mesatare.

I burgosuri që vrau një 10-vjeçar pëson dëmtime të lehta

"Monstra e Peshkopisë" i vë flakën qelisë së burgut

Shpëtim Ziza është dënuar me burgim përjetë

FUSHE-KRUJE

Një ngjarje e paprecedent ka ndodhur në burgun e Fushë-Krujës, ku i burgosuri Shpëtim Ziza i ka vënë flakën qelisë së burgut. I burgosuri Ziza ka pësuar disa lëndime në trup dhe momentalisht ndodhet në spitalin e burgut nën kujdesin e mjekëve. Ziza njihet ndryshe edhe si "Monstra e Peshkopisë". Ai është dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e 10-vjeçarit, Besim Çenga, ngjarje e ndodhur në tetor të vitit 2007, ndërsa tronditi mbarë opinionin publik.

NGJARJA HORROR

Vogëlushi Besim Çenga u zhduk pa gjurmë më 23 tetor të 2007-ën, ndërsa trupi pa jetë i 10-vjeçarit u gjet në një përrua afër fshatit Tomini të rrethit të Dibrës, 7 km larg Peshkopisë pas 5 ditësh. Ai ishte fëmija i madh i shtetasit Ylli Çenga, banor i lagjes 'Kamen' të qytetit të Peshkopisë. Sipas vendimit të gjykatës, Shpëtim Ziza kishte mashtruar 10-vjeçarin duke e ftuar të shkonte me të për të luajtur, ndërsa prej 5 ditësh fëmija nuk ishte thyer në shtëpi. Ngjarja ishte makabre për të dy familjet. Shpëtimi, i cili vuan nga problemet e shëndetit mendor e ka pranuar krimin asokohe, duke pohuar se e kishte përdhunuar vogëlushin dhe më pas e kishte mbytur me lidhëse këpucësh.

RASTI I DYTE

Rreth dy vjet më parë ai ka tentuar që të vetëvaret në ambientet e burgut të Zaharisë. Dy prindërit e tij denoncuan në emisionin 'Me zemër të hapur' në 'News24' gjenden dhe kushtet me të cilat përballlet djali i tyre në burg, ndërsa pohan se ai është mbyllur në një kafaz me hekur brenda qelisë. Ata kanë mohuar kategorikisht faktin se djali i tyre ka lidhje me vrasjen e



Shpëtim Ziza

vogëlushit, ndërsa akuzuan sistemin e drejtësisë për korrupsion. Nëna e Shpëtim Zizës, Melita ngriti akuzë për drejtuesit e institucionit ku vuanë dënimin djali i saj, pasi sipas saj ai dhunohej brenda qelisë dhe nuk kurohej. "Është varur, ka preurë damarët, ka nuk ka bërë. Do vdes, do shkoj tek vëllai. Ka tentuar që të varet në banjë, por e kanë shpëtuar serish. Njëherë e çuan me urgjencë në spital. Para 3 muajve shkova te djali e më tha: 'S'jam mirë më kanë rrahur. Kur shoh unë çarçafët, ishin gjithë gjak. I thash këtë kam, budalla apo të saktë. I thash pse ma rrihni. I mora çarçafët dhe thash do iu bëj ekspertizën. Unë kam prova, policët e dhunojnë. Drejtori i burgut më thotë se ai shan", pohoi nëna.

Aksident në rrugën e "vdekjes", vdes 76-vjeçari, plagoset gruaja

Një aksident është shënuar mbrëmjen e së dielës në aksin Lezhë-Shkodër, me pasojë vdekjen e një personi. Aksidenti ka ndodhur në zonën e 'Kryqëzimit të Gjadrit' në autostradën Lezhë-Shkodër, në vendin e quajtur 'Kryqëzimi i Gjadrit'. Një makinë ka përplasur një motocikletë, duke shënuar vdekjen e të moshuarit 76 vjeç me iniciale N.Gj dhe plagosjen e gruas së tij 75-vjeçares me iniciale N.Gj, të cilët u udhëtonin me motocikletë. Ndërkohë, burime nga policia bëjnë me dije se drejtuesi i mjetit 36-vjeçari me iniciale A.H është shoqëruar në polici dhe po punohet për sqarimin e rrethanave të aksidentit. 75-vjeçarja, e cila mbeti e plagosur është transportuar menjëherë në spitalin Rajonal në Lezhë ku ndodhet nën kujdesin mjekësor.

NJOFTIMI SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e tretë për pasurinë:

1- Truall, me sipërfaqe 250 m² dhe sipërfaqe ndërtëse 85m², e ndodhur në Bëtkocë, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 183150, Vol. 20, Faqe. 70, ne pronësi të Vasil Ferit Muceku. Cimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 630.000(gjastënjëqind e tridhjetë mijë) LEKË

Ankandi i tretë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 23.05.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr.kontakti 069381883.

Policia arreston 4 grabitës serial në Vlorë. Ja akuzat

Policia e Vlorës në kuadër të operacionit të koduar "Triporti" ka vënë në pranga 4 shtetas për kryerjen e një sërë vjedhjesh. Ata janë: E.H., 31 vjeç, banues në Vlorë, V.I., 19 vjeç, banues në Vlorë, A.N., 29 vjeç, banues në Vlorë dhe I.L., 18 vjeç, banues në Vlorë. Këta shtetas janë arrestuar nga shërbimet e policisë për arsye se më datë 04.05.2019, në orët e para të mëngjesit kanë vjedhur Pikën e Bllokimit dhe Rruajtjes së Mjeteve "Triport-Vlorë" duke marrë 3 motocikleta, mjete të cilat ishin lënë ruajtje nga shërbimet e qarkullimit për veprime të mëtejshme administrative. Gjithashtu, nga hetimet e kryera në drejtim të këtyre personave, ka rezultuar se janë autorë të dyshuar për 5 vjedhje të tjera, të cilat i kryenin në orët e vona të natës me qëllim që të mos identifikoheshin, konkretisht:

Më datë 17.04.2019, në lagjen "Hajro Çakërrri" dyshohet se kanë vjedhur një motor në pronësi të shtetasit S.R.

Më datë 08.03.2019, në pikën e bllokimit të mjeteve në Tripot, Vlorë, dyshohet se kanë vjedhur dy targa automjesh.

Më datë 02.02.2019, dyshohet se kanë vjedhur disa krerë shpezë në pronësi të shtetasit R.P., Vlorë.

Më datë 14.03.2019, në fshatin Nartë, Vlorë, dyshohet se kanë vjedhur 3 bagëti të imta në pronësi të shtetasit J.Xh.

Më datë 08.04.2019, në lagjen "Kushtrimi" Vlorë, dyshohet se kanë vjedhur disa krerë shpezë në pronësi të shtetasit E.S.

Materialet i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për veprime të mëtejshme në ngarkim të këtyre shtetasve.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbaruese gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 30.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i II-të për shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të Z.Shpëtim Barjam Boci:

- Truall me sipërfaqe 2863 m², Nr.pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Volumes 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 48'098.4 (Dyzet e tetë mijë e nëntëdhjetë e tetë pikë katar) EURO
- Truall me sipërfaqe 2317 m², Nr.pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Volumes 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 38'925.6 (Tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë pikë gjashtë) EURO
- Truall me sipërfaqe 790 m², Nr.pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Volumes 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 13'272 (Trembëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) EURO
- Truall me sipërfaqe 780 m², Nr.pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Volumes 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 13'104 (Trembëdhjetë mijë e njëqind e katër) EURO
- Truall me sipërfaqe 1750 m², Nr.pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Volumes 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 29'400 (Njëzet e nëntë mijë e katërqind) EURO

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



M.K: Nuk kam konflikte me askënd

"Krifet" një biznesmen nga Fieri, ja shumat e makinat

Një subjekt privat ka rënë pre e grabitjes këtë të diel në qytetin e Patosit. Të dhënat e para tregojnë se ngjarja ka ndodhur rreth orës 03:00 të mëngjesit. Vetë pronari i subjektit në fjalë, shtetasi

me iniciale M.K ka treguar se autorët kanë vjedhur dy automjete, një "Audi" e një "Land Rover", 2800 euro dhe 60 000 lekë të rinj, të gjitha në pronësi të shtetasi në fjalë. Në subjekt janë shkaktuar edhe dëme të

shumta materiale, të konstatuara nga vetë pronari i tij mëngjesin e sotëm. Menjëherë pas ngjarjes shtetasi me iniciale M.K, ka bërë denoncimin në polici duke sqaruar se nuk ka asnjë konflikt të mëparshëm. Për

të zbardhur ngjarjen, nga ana e bluve janë sekuestruar edhe pamjet e kamerave të sigurisë, ndërsa paraprakisht mendohet që mund të kenë qenë më shumë se dy autorët e kësaj ngjarje. Nga ana e policisë po punohet për zbardhjen e shkaqeve të ngjarjes si dhe kapjen e autorëve.

Karabinierët: Aksioni ishte i rastësishëm, çfarë i zbuloi

Policia italiane kap 100 kile marijuanë, ja vlera e drogës

Arrestohen një italian dhe një shqiptar

Policia në Torino ka zbuluar dhe sekuestruar rreth 100 kg marijuanë, teksa ka arrestuar trafikantët. Në pranga ranë dy persona: një shtetas italian (44 vjeç), i lindur në Romë dhe banues në Asti, si edhe një shtetas shqiptar (38 vjeç), banues në Piemonte. Sipas media-ve italiane, droga ishte e vendosur në qese të kuqe, të fshehura në ndenjset e pasme të makinës tip "Ford C Max", me të cilën udhëtonin dy personat e arrestuar.

Ishin agjentët e policisë, të cilët në atë kohë ishin të angazhuar në një tjetër shërbim, që vunë re lëvizjet e dyshimta të mjetit, pasi panë patrullën e policisë. Shoferi (i cili më vonë u zbulua se ishte shtetas italian) ishte i shqetësuar nga kalimi i rastësishëm i patrullës dhe ndryshoi drejtim, kështu agjentët vendosën që t'i ndiqnin. Ata mundën t'i ndalojë dy personat në rrugën "Lancia", në banesën e shqiptarit. Pas kontrollit në banesë, u gjendën edhe tre peshore elektronike dhe materiale për paketimin e drogës. Menjëherë autoritetet nisën hetimet që të gjurmojnë bashkëpunëtorët e mundshëm dhe "rrjetin" që ndihmoi dy trafikantët në transportin e drogës. "Ishte një aksion i lindur pothuajse aksidentalisht, pas intuitës hetimore të disa oficerëve të policisë që shfrytëzuan manovrat e dyshimta të një ndërlihdësi droge"- shpjegon udhëheqësi i skuadrës së policisë së patrullës, Marco Martino. Droga, vlen rreth 300,000 euro me çmim shumice dhe pothuajse 1 mln euro në shitje me pakicë.



H ZBULIMI
Ishin agjentët e policisë, të cilët në atë kohë ishin të angazhuar në një tjetër shërbim, që vunë re lëvizjet e dyshimta të mjetit, pasi panë patrullën e policisë. Shoferi (i cili më vonë u zbulua se ishte shtetas italian) ishte i shqetësuar nga kalimi i rastësishëm i patrullës dhe ndryshoi drejtim, kështu agjentët vendosën që t'i ndiqnin. Ata mundën t'i ndalojë dy personat në rrugën "Lancia", në banesën e shqiptarit. Pas kontrollit në banesë, u gjendën edhe tre peshore elektronike dhe materiale për paketimin e drogës.

Në pranga ranë dy persona: një shtetas italian (44 vjeç), i lindur në Romë dhe banues në Asti, si edhe një shtetas shqiptar (38 vjeç), banues në Piemonte.



KfW Entwicklungsbank, one of the world's leading bilateral development banks, is an integral part of KfW Bankengruppe. Currently we finance and guide some 1,800 projects in over 100 countries. In Albania KfW primarily supports projects in the energy sector, municipal infrastructure and sustainable economic development. KfW Entwicklungsbank works on behalf of the German Government, helping to achieve the goals set for German Development Cooperation. For its office in Tirana, KfW Entwicklungsbank is looking for a highly qualified and motivated

PROJECT COORDINATOR

The Coordinator's role is to provide support to the project acquisition, preparation, implementation and monitoring process in close coordination with the office's director and the respective project managers in Frankfurt, Germany. To this end, he/she will

- build up and maintain excellent contacts to project partners and clients, i. e. relevant sector ministries, local government administrations as well as state-owned enterprises;
- help to develop new projects in line with the priority areas defined by the Government and in line with headquarters strategies;
- screen and assess project proposals received with regard to their plausibility and feasibility;
- prepare and support project appraisal and evaluation missions;
- attend and minute meetings with project partners;
- draft documents and correspondence;
- continuously research, monitor and report on market and sector developments including relevant government sector policies as well as legislation;
- represent KfW Entwicklungsbank vis-à-vis all relevant partner institutions (associations, donor agencies, etc.), and during important events; and
- generally facilitate procedures and communication with partner institutions and clients and support KfW's Tirana Office in its various functions.
- The portfolio will tentatively cover the environment (energy efficiency in Public Buildings, green transport, Biodiversity and Nature Conservation) as well as TVET

Necessary qualifications:

- University degree in Economics, Business Administration, Public Law, Engineering or related fields of study
- 3-5 years of work experience in finance or development cooperation
- strong and proven analytical skills
- computer literacy skills (MS Office)
- fluent in English (both written and spoken)
- generally facilitate procedures and communication with partner institutions and clients and support KfW's Tirana Office in its various functions
- excellent organizational skills and ability to manage / follow-up on complex administrative processes
- excellent communication and negotiation skills, highest level of integrity, autonomy in the day-to-day work
- proven ability to work in a team
- cooperation experience with government institutions and familiarity with public procurement and budgeting procedures would be a strong asset
- Previous experience in the areas of environment (as defined above) and/or TVET will be an asset

The position is tendered as a full-time fixed-term contract of one year with possibility of extension; application for part-time will be considered. Starting date is September 1st 2019

Contact:
Candidates are requested to send their motivation letter (mandatory), CV and credentials as one pdf not exceeding 10 MB to the following address: career.tirana@kfw.de
Deadline for submission of applications is **May 15th, 2019**.
Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbartimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbartuese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë :

1. "ARE": me sipërfaqe totale 261.00 m2 ,e ndodhur në Q/ F Kamëz, Rrethi Tiranë , në Zonën Kadastrale: 2066 , Numri i Pasurisë: 93/462, Vol. 45, Faqe. 63, me pronesi te Tatjana Man Allushi dhe Hasan Sulejman Allushi. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 1,000,000 (një milion) . LEKE

Ankandi i pare per pasurine e mesiperme zhvillohet me datë 15.05.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës se përmbartuese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

Kreu i Shoqatës së të Verbërve: Mos të preken standardet e arritura deri sot

Ardjan Hysa: Draftreforma e qeverisë, ulje e pagesave të aftësisë së kufizuar

"Klasifikimi në 4 grupe, ja sa para do të marrë secili"

Voltiza Duro

Draftreforma më e re e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për aftësinë e kufizuar, ka hasur në kundërshtimin e kësaj kategorie. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', Ardjan Hysa, president i Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, tregon të gjitha problematikat dhe cenimin që mund t'i bëhet personave me aftësi të kufizuar nëse miratohet kjo draftreforma. Ai thekson se do të ketë ulje të pagesave që do të arrijnë deri në 60 mijë lekë të vjetra, sipas grupeve të caktuara. Hysa i bën thirrje qeverisë shqiptare që të mos cenojë standardet e arritura deri më sot për përmirësimin e jetës së individëve me aftësi të kufizuara.

Sa është numri i personave që kanë statusin e të verbrit në Shqipëri dhe cilat janë disa nga problematikat që ju shqetësojnë kryesisht?

Problematikat e të verbërve në vendin tonë janë të shumëllojshme dhe prekin jo vetëm të verbrit, por të gjithë personat me aftësi të kufizuar. Problemet lidhen drejtpërdrejt me jetën, me kafshatën e bukës dhe me dinjitetin tonë, pasi janë në varësi të të ardhurave që marrim apo shërbimeve të ndryshme që i kemi të domosdoshme. Por këto probleme duken shumë të veshitura për tu zgjidhur. Ajo çka neve na shqetëson më shumë është draftreforma, e cila po përpiqet të implementohet nga personat përgjegjës që janë marrë me të e që janë pjesë e qeverisë. Ne jemi pro një reforme, pro vendosjes së kriterëve të OBSH-së për klasifikimin e PAK, jemi pro gjithçkaje që ka të bëjë me shmangien e abuzimeve, por kurrësi ne jemi kundër cenimit të standardeve të arritura deri më sot.

Në çfarë konsiston konkretisht kjo draftreforma që mund të prekë interesat tuaja?

Kjo draftreforma nuk prek thjesht të verbrit, por gjithë kategoritë e aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Më habit fakti që shumë drejtues të aftësisë së kufizuar nuk po ndihen ndaj kësaj padrejtësie. Sipas draft reformës qeveria ka konsistuar që ka disa kategori të privileguara të PAK, si të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët. Qeveria mendon se mun-



Kreu i Shoqatës së të verbërve, Ardjan Hysa

DRAFTREFORMA

Kjo draftreforma nuk prek thjesht të verbrit, por gjithë kategoritë e aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Më habit fakti që shumë drejtues të aftësisë së kufizuar nuk po ndihen ndaj kësaj padrejtësie.

Sipas draft reformës qeveria ka konsistuar që ka disa kategori të privileguara të PAK, si të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët. Qeveria mendon se mungon një përshkallëzim i nevojave të shkaktuara prej aftësisë së kufizuar. Së treti, ata pretendojnë se duhet të ketë një moshë tavan për marrjen e statusit të aftësisë së kufizuar.

gon një përshkallëzim i nevojave të shkaktuara prej aftësisë së kufizuar. Së treti, ata pretendojnë se duhet të ketë një moshë tavan për marrjen e statusit të aftësisë së kufizuar. Nëse p.sh. kalon moshën 65-vjeç të daljes në pension, nuk mund të përfitojë nga statusi i aftësisë së kufizuar, nëse problematikat shëndetësore i shfaqet personit pas moshës së daljes në pension. Gjithashtu, qeveria pretendon se nuk ka një diferencim të pagesave të fëmijëve me të rriturit, pavarësisht se mund të jenë të të njëjtit grup. Ministria pretendon se është bazuar në modele ndërkombëtare për hartimin e kësaj draftreforme, por në asnjë rresht

të saj nuk përcaktohet ekzaktesisht se ku janë bazuar.

Si parashikohet të kryhet klasifikimi i aftësisë së kufizuar sipas draftreformës?

Sipas draft-reformës, klasifikimi i aftësisë së kufizuar do të bëhet në katër grupe. Në grupin e parë do të bëjnë pjesë të gjithë ata persona që do të kenë humbje të aftësisë të tyre jetike, funksionale në masën 96-100% të këtyre aftësisë. Këta persona do të kenë nevojë për një mbështetje intensive të përhershme e do të trajtohen me një pagesë prej 120% të pagesës bazë të aftësisë së kufizuar. Kjo e fundit është sa 150% e pensionit social. Pra, 120% i 108 mijë

lekshit, është diku te 129 mijë e 600. Këtë pagesë e marrin personat që janë të paralizuar, por që kanë jo vetëm një aftësi të dëmtuar. Në një takim që kemi bërë me z.vministren, kjo e fundit na tha se kjo kategori do të hyjnë ata persona që marrin frymë. Pra, mesa duket këtë pagesë mund ta marrin personat në vdekje klinike apo që rrinë në krevat gjithë jetën.

Cili është grupi i dytë sipas këtij klasifikimi dhe sa do të jetë pagesa për ta?

Në grupin e dytë do të futen të gjithë ata persona që kanë humbje të kapaciteteve funksionale në masën 50-95%. Edhe këta persona kanë nevojë për mbështetje të përhershme dhe intensive. Një i verbër i grupit aktual, mund të mos e gjejë veten në këtë grup. Grupi i dytë i paraplegjikëve në draftreformë do të marrë rreth 108 mijë lekë. Një i verbër aktualisht merr rreth 120 mijë lekë të vjetra, pra do të ketë rreth 12 mijë lekë humbje. Qeveria mendon se një i verbër nuk e ka të nevojshëm ndihmësin personal në mënyrë të përhershme, por mund ta marrin në telefon kur të na nevojitet. Këtu luhet me hile! Nëse komisioni thotë që një i verbër s'ka nevojë për kujdestar të përhershëm do të kalojë te grupi i tretë.

Sa para do të marrë

KLASIFIKIMI I AFTËSISË

Sipas draft-reformës, klasifikimi i aftësisë së kufizuar do të bëhet në katër grupe. Në grupin e parë do të bëjnë pjesë të gjithë ata persona që do të kenë humbje të aftësisë të tyre jetike, funksionale në masën 96-100% të këtyre aftësisë. Këta persona do të kenë nevojë për një mbështetje intensive të përhershme e do të trajtohen me një pagesë prej 120% të pagesës bazë të aftësisë së kufizuar.

GRUPI I TRETË SIPAS DRAFTREFORMËS?

Grupi i tretë do të përfshijë ata persona që kanë një humbje të aftësisë në masën 25-50% dhe këta do të marrin sa 80% i pagesës bazë të aftësisë së kufizuar, që përlogaritet rreth 85 mijë lekë të vjetra. Pra, ish kemi ulje pagese, nga 120 mijë lekë deri në 85 mijë lekë të vjetra. Edhe ndihmësi i të verbrit do të marrë po të njëjtën masë parash. Pra ka një rënie rreth 30%. Ndërkohë në grupin e katërt do të përfshihen ata persona që kanë një humbje të aftësisë nga 5-25%.

Po për grupin e katërt sa do të jetë pagesa e përcaktuar? A do të ketë rënie?

Ka mundësi të zgjerohet skema, sepse thuhet që për këtë grup do të ofrohen shërbime të ndryshme, për të cilat kanë nevojë. Por në momentin që s'do të jetë i mundur ofrimi i shërbimeve ata do të marrin rreth 60-70 mijë lekë të vjetra. Fakti që është vendosur një hapësirë e tillë, ka mundësi të zgjerohet kategoria e PAK, por do të kenë pagesën shumë më të ulët. Normalisht që duhet të ketë pikëzime, por kjo situatë bie në kundërshtim me të drejtat tona.

Çfarë do të sillte ndryshe vendosja e moshës tavan për marrjen e pagesës së aftësisë së kufizuar?

Vendosja e moshës

tavan, ka të bëjë me një moshë të caktuar brenda së cilës një person mund të përfitojë statusin e aftësisë së kufizuar. Nëse një person kalon moshën e daljes në pension, edhe pse ai mund të verbohet, pavarësisht arsyeve të verbimit, nuk do të përfitojë më status të aftësisë së kufizuar. Sipas hartuesve të draftit, kjo paftësi në këtë moshë, vjen nga mosha. Por logjikisht, kjo moshë duhet të ketë më shumë nevojë për mbështetje dhe ne e dimë që për sa kohë shteti nuk do ofrojë shërbimet e duhura, si do të mbahen këta persona e me çfarë do të jetojnë këta?

Drafti parashikon edhe diferencimin e pagesave të fëmijëve dhe të rriturve. Si mendoni lidhur me këtë?

Sipas qeverisë, fëmijët nuk kanë nevojë për të njëjtën pagesë si një i rritur, pavarësisht se mund të jenë brenda të njëjtit grup. Kjo është shumë e rëndë, sepse një fëmijë i vogël ka nevojë për shumë gjëra por kaq të rëndësishme sa një i rritur. Pagesat për një fëmijë me aftësi të kufizuar janë më të domosdoshme sesa për një moshë tjetër.

A janë konsultuar me shoqatën tuaj para hartimit të draftit?

Ne jemi thirrur në një takim dhe problematikat që po ngre sot, ia kam treguar edhe ekspertëve, por nuk u mor asgjë në konsideratë. Kjo më bën skeptik lidhur me vendimet që mund të marrin për kategoritë e aftësisë së kufizuar. Qeveria nuk do të lejojë më që një person me aftësi të kufizuara të ketë dy lloj pagesash. P.sh. aktualisht një person mund të jetë i verbër dhe invalid pune dhe do të marrë dy pagesa për këtë. Por këtë nuk duan ta lejojnë më.

Cilat janë kërkesat tuaja ndaj qeverisë shqiptare?

Ajo që ne kërkojmë është moscenimi i standardeve të arritura deri më sot, e që mbrohen nga konventa e ligji. Pushtetarët dalin e thonë që nuk na preken standardet, ndërkohë që e vërteta është shumë ndryshe. Ne jemi kundër një klasifikimi jo-profesional.

PENSIONET E PLEQËRISË NDRYSHIMET

"Indeksimi 2.8%, sa do të jetë masa e një pensioni minimal dhe maksimal"

Vendimi i qeverisë: Rritje pensionesh për 665 mijë pensionistë në vend

Cilat janë kategoritë që do të marrin më shumë para

Voltiza Duro


P prej muajit prill ka ni sur rritja e pensioneve për 665 mijë përfitues. Sipas VKM-së rritjen nga indeksimi në masën 2.8% e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve të pleqërisë. Duke nisur nga pensionet e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore për të vijuar te pensionet sociale; pensionet e invaliditetit përfshirë edhe invalidët e luftës; pensionet familjare; pensionet e veçanta të ushtarakëve; pensionet suplementare shtetërore të punonjësve në universitete apo qendra studimore etj. E thënë ndryshe në numra, përfituesit nga indeksimi 2.8%, janë rreth 638 mijë persona që trajtohen me pensionet e lartpërmendura. Nga kjo rritje po ashtu do të përfitojnë edhe rreth 100 mijë individë të tjerë që bëjnë pjesë në skema të tjera. Pra, në total do të përfitojnë nga indeksimi rreth 740 mijë persona që jetojnë në territorin e Shqipërisë si dhe ata pensionistë që përfitojnë një pension pleqërie në Shqipëri, por që jetojnë jashtë territorit shqiptar.

MASA E RITJES

Duke ju referuar VKM-së, është marrë vendimi që pas datës 1 prill 2019 pensionet e ndryshme të pleqërisë të caktuara me ligjin nr.150/2014 që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014, nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj. Përsëri jo më pak se 13 753 lekë s'do të jenë as pensionet e parakohshme. Pensionet e pleqërisë s'do të jenë më shumë se 27 506 lekë. Pra, indeksimi do të jetë nga 385 lekë deri më 770 lekë. Pra, pensioni minimal shkon 13753 lekë, nga 13378 lekë që ishte deri tani, ndërsa pensioni maksimali shkon në 27 506 lekë në muaj, nga 26757 lekë në muaj që ishte deri tani.

PËRFITUESIT

Këshilli i Ministrave vendosi në mbledhjen e fundit rritjen e pensioneve në masën 2.8%. Në dispozicion të rreth 665 mijë pensionistëve është vënë një fond prej 2.39 miliardë lekësh. Pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore përvëç rritjes me 2.8%, do të përfitojnë edhe kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin të ardhurave, të jetë: a) deri në 15 403 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë; b) deri në 14 903 lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet



H VENDIMI

Duke ju referuar VKM-së, është marrë vendimi që pas datës 1 prill 2019 pensionet e ndryshme të pleqërisë të caktuara me ligjin nr.150/2014 që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014, nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj. Përsëri jo më pak se 13 753 lekë s'do të jenë as pensionet e parakohshme.

familjare; c) deri në 10 108 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare. Kompensimet për të ardhura mujore minimale nisin nga 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 403 lekë në muaj. Janë 16 kategori pensionesh që përfitojnë rritjen. Në vendim është përcaktuar edhe kufiri minimal dhe maksimal për pensionet e plotë të pleqërisë, pensionet e plotë të invaliditetit dhe pensionet e plotë familjare, pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim dhe përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993. Sipas vendimit, mësohet se përfi-

tojnë rritje pensionet e caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", pensionet sociale. Shtesë mujore në masën 2.8% do të përfitojnë edhe personat që trajtohen me mbrojtje të veçantë të ushtarakut, pensionet suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë". Rritje në masën 2.8% do të përfitojnë edhe rastet e trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas

RRITJA E PENSIONEVE

■ Pensioni minimal
Ishte 13378 lekë në muaj
Bëhet 13753 lekë në muaj
■ Pensioni maksimal
Ishte 26757 lekë në muaj
Bëhet 27 506 lekë në muaj

ligjeve nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, dhe nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar dhe rastet e trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënofficerë, lundrues të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension". Rritja do të aplikohet për personat që trajtohen me pagesa të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, "Për një tra-

KOMPENSIMET

Kompensimet për të ardhura mujore minimale nisin nga 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 403 lekë në muaj. Janë 16 kategori pensionesh që përfitojnë rritjen.

ATA QE PERFITOJNE

Shtesë mujore në masën 2.8% do të përfitojnë edhe personat që trajtohen me mbrojtje të veçantë të ushtarakut, pensionet suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë".

PERFITUESIT

Kushtet e përfitimit:

- Personat që kanë moshën dhe periudhat e sigurimit, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqërisë
- Nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë mbi 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet periudhë sigurimi.

PENSIONI I PLOTË I PLEQËRISË SI NËNË ME SHUMË FËMIJË

Kushtet e përfitimit:

- Personat që kanë periudha sigurimi, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë kur:
- Plotësojnë moshën 55 vjeç;
- Kanë 30 vjet periudhë sigurimi;
- Janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike;
- Kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë të rritur mbi 8 vjeç.

jtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë"; pensionet suplementare të caktuara sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së

Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë". Për efektet në pikën dy të vendimit të Këshillit të Ministrave përcaktohet se indeksimin e pensionit e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.3.2019, përfshirë edhe këtë datë.

"Ka organizata që riqarkullojnë dhe eksportojnë produkte bujqësore në vende të treta"

Siguria ushqimore, konfindustria pro ashpërsimit të Kodit Penal

Buxhuku: Mbrohen industritë, bizneset dhe fermerët vendorë

Konfindustria mbëshet në nismën e Kuvendit të Shqipërisë për ashpërsimin në Kodin Penal të ndëshkimeve ligjore ndaj shkelësve të standardeve të sigurisë në prodhimet ushqimore dhe bujqësore në tregun vendor, por kërkon marrjen e masave shoqërore për zbatimin e tij efektiv nga agjencitë shtetërore. Në rast të kundërt rrezikohet jo vetëm qëllimi i nismës ligjore, por krijon kushte për rritjen e shkallës së korrupsionit, goditjen e bujqësisë, industrisë agroushqimore dhe turizmit, biznesit të ndershëm dhe humbjen e mëtejshme e besimit të konsumatorëve me pasojë të rënda në afatgjatë për ekonominë kombëtare. Konfindustria vlerëson, se rritja e fuqisë ndëshkuese të ligjit dhe zbatimi efektiv nga agjencitë shtetërore për mbrojtjen e sigurisë ushqimore në tregun shqiptar është e rëndësishme së shumtë. "Së pari, mbrohen industritë, bizneset dhe fermerët e ndershëm vendorë, që konkurohen në çmim nga prodhimet jashtë standardit të vendit dhe të importit. Së dyti, industritë dhe fermerët e ndershëm shqiptarë goditen rëndë nga humbja e besimit të konsumatorëve. Së treti, siguria ushqimore është e lidhur drejtpërdrejt me industrinë e turizmit në Shqipëri", shpreh Gjergj Buxhuku. Ai vlerëson, se shkak kryesor për sigurinë ushqimore të rrezikuar në tregun shqiptar është paaftësia, subjektivizmi, korrupsioni i agjencive shtetërore të fushës. Sipas të dhënave në mjaft vende të rajonit dhe më gjerë, shumë prej të cilëve edhe partnerë të rëndësishëm tregtarë të Shqipërisë, janë të pranishme dhe funksionojnë rrjete të organizuara kriminale.



SIGURIA USHQIMORE

Shkak kryesor për sigurinë ushqimore të rrezikuar në tregun shqiptar është paaftësia, subjektivizmi, korrupsioni i agjencive shtetërore të fushës. Sipas të dhënave në mjaft vende të rajonit dhe më gjerë, shumë prej të cilëve edhe partnerë të rëndësishëm tregtarë të Shqipërisë, janë të pranishme dhe funksionojnë rrjete të organizuara kriminale.

Konfindustria vlerëson, se rritja e fuqisë ndëshkuese të ligjit dhe zbatimi efektiv nga agjencitë shtetërore për mbrojtjen e sigurisë ushqimore në tregun shqiptar është e rëndësishme së shumtë. "Mbrohen industritë, bizneset dhe fermerët e ndershëm vendorë, që konkurohen në çmim nga prodhimet jashtë standardit të vendit dhe të importit.

ARRSH: DENONCIM PAS HEQJES SË 35 TABELAVE DYGJUHËSHE NË SARANDË

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka ndihmuar policinë për heqjen e tabelave dygjuhëshe në rrugën kombëtare Qafë Muzinë - Sarandë - Konispol. Sipas ARRSH ish-in 35 tabelat e vendosura jashtë standardeve të përcaktuara në Kodin Rrugor dhe pa miratimin e entit pronar të rrugës Autoritetit Rrugor Shqiptar. Tabelat, siç sqaron ARRSH u vunë në dispozicion të policisë si provë e paligjshmërisë së konstatuar si dhe është bërë denoncim në policinë e Sarandës në lidhje me çfarë u konstatua. ARRSH shton se këto tabela sinjalizuese nuk plotësonin specifikimet teknike të përcaktuara në legjislationin në fuqi për sa i përket renditjes së emërtimeve në gjuhën shqipe dhe atë minoritare, ngjyrës dhe madhësisë së shkrimit të përdorur. "Sa me sipër, çdo palë e tretë jo ent pronar i rrugës, në kushtet kur vendos të ndërhyjë në rrugë apo vendosje sinjalistike treguese për zonat e banuara, duhet t'i referohet "Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" dhe V.K.M Nr.446,"- shpjegon ARRSH.



FOTOLAJM

Balotazhi për përzgjedhjen e kreut të vendit, shqiptarët faktor kryesor

Zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut, Pendarovski kryeson me 10% të votave

Me 44% të pranishëm, KSHZ: Atmosferë e qetë dhe demokratike

Maqedonia e Veriut votoi dje për Presidencën e ardhshme të vendit. Ky është raundi i dytë i votimeve pasi në të parin dështoi votimi si pasojë e interesimit të vogël të qytetarëve për të dalë në votime. Të dhënat e para të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut, tregojnë një epërsi prej 10 për qind të votave në favor të kandidatit të partisve në pushtet, Stevo Pendarovski. Edhe Lidhja Social-Demokrate e kryeministrit Zoran Zaev ka publikuar rezultatet e para nga rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale, me epërsi të Stevo Pendarovskit që kishin mbështetjen e 31 partive politike, përfshirë edhe të BDI-së dhe dy partive tjera shqiptare që janë pjesë e qeverisë. Sipas LSDM-së, zgjedhjet kanë qenë të rregullta duke dëshmuar kapacitetin demokratik të Maqedonisë së Veriut. Në zgjedhjet është arritur pragu zgjedhor prej 40 për qind si kusht për suksesin e zgjedhjeve. "Qytetarët në mënyrë masovike shfrytëzuan të drejtën e votës dhe paqësisht dhe me dinjitet zgjodhën presidentin e pestë të shtetit. Republika e Maqedonisë së Veriut zhvilloi zgjedhje të pastra si kristali, të lira e demokratike ashtu siç i ngjan një shteti demokratik modern evropian. Stevo Pendarovski është në epërsi dhe presim fitore", ka deklaruar Aleksandar Kiracovski, shef i shtabit zgjedhor të LSDM-së. Edhe BDI-ja ka thënë se është e kënaqur nga mbarevajtja e procesit zgjedhor. Izet Mexhiti nga BDI-ja tha se kjo parti "ka siguruar rreth 90.00 vota shqiptare për kandidatin e LSDM-së". 1.79% ishte pjesëmarrja në raundin e parë, apo 755.702 votues zgjodhën në mes Blerim Rekës, Gordana Siljanovska-Davkova dhe Stevo Pendarovski. Pas numërimit të votave nga KSHZ-ja, rezultatet ishin: Blerim Reka - 79921 apo 10.58% të votave, Gordana Siljanovska-Davkova - 319.225 apo 42.24% të votave, Stevo Pendarovski - 323714 apo 42.84% të votave. Si në gjithë ciklet e tjera zgjedhorë, edhe këtë herë kishte 32811 vota të pavlefshme, apo 4.34% të votave të përgjithshme. Maqedonia e Veriut zgjedh presidentin e pestë me radhë në procesin e gjashtë zgjedhor. Më herët president të shtetit kanë qenë: Gjorg Ivanov me dy mandate (2009-2019), Brančo Cërvenkovski (2004-2009), Boris Trajkovski (1998-2003, ndërroi jetë si president) dhe Kiro Gligorov (1992-1998 - i mbijetoi atentatit). Dje zgjedhjet u mbajtën për herë të parë me emrin e ri të shtetit, pas marrëveshjes me Greqinë për riemërimin e Maqedonisë në Maqedonia e Veriut. Shqiptarët në pjesën



e dytë të fushatës, pas raundit të parë, janë thirrur që të votojnë pasi vota e tyre konsiderohet vendimtare për numrin e pjesëmarrësve. Rregulli për rrethin e dytë sipas Ligjit për zgjedhjet presidenciale është i qartë. Për t'u zgjedhur President duhet që në zgjedhje të dalin të paktën 40% e votuesve, apo 723,252 votues nga Lista zgjedhore që numëron 1,808,131 votues gjithsej. Ditën e djeshme u mbajtën edhe zgjedhjet lokale në Ohër dhe komunën e Novo Sellës. Votuesit mund të zgjedhin në mes njërit garues, i kon-

sideruar si i moderuar dhe pro-perëndimor dhe tjetrit që mund të bllokojë proceset integruese të vendit. Stevo Pendarovski është kandidat i Lidhjes Social-Demokrate i mbështetur edhe nga Bashkimi Demokratik për Integritet dhe një sërë partizh të tjera më të vogla e organizata joqeveritare. Ndërsa, Gordana Siljanovska-Davkova garon si kandidatë presidenciale e VMRO-DPMNE-së së opozitës, e vlerësuar si nacionaliste. Të dy garuesit dhe përkrahësit e tyre e kanë të qartë se pa votat e shqiptarëve nuk bëhen pres-

ident dhe ata kanë zhvilluar një fushatë në këto dy javët e fundit duke u përqendruar në tërheqjen e votuesve shqiptarë. Stevo Pendarovski ofron konceptin "Një shtet për të gjithë", një shtet ku nuk do të ketë padronë dhe qiraxhinj apo të nënrenditur, as qytetarë të rendit të parë e të rendit të fundit, siç shprehej ai në një intervistë për "Zërin e Amerikës". Ndërkaq, Gordana Siljanovska ka zhvilluar një fushatë me sulme ndaj kundër kandidatit presidencial Pendarovski dhe Lidhjes Social-Demokrate në pushtet, duke i paraqitur ata si përgjegjës për shitjen, sipas saj të emrit, të popullit dhe identitetit maqedonas. Ajo është shprehur se ajo vetë nuk do ta përdorë emrin "Republika e Maqedonisë së Veriut" nëse bëhet president, dhe se do të kërkojë mënyra për kthimin e emrit Republika e Maqedonisë. Siljanovska po ashtu mund të paraqesë probleme, sipas analistëve, ndaj ligjit që i mundëson një shtrirje të gjerë përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut. Në balotazh duhet të dalin mbi dyzet për qind e votuesve, përndryshe zgjedhjet quhen të pavlefshme. Në atë rast, Kryetari i parlamentit, Talat Xhaferi do të merrte përgjegjësi të ushtrues i detyrës së presiden-

tit deri në organizimin e zgjedhjeve të radhës, pas një periudhe prej gjashtë deri nëntë muaj. Zoti Xhaferi ka lënë të kuptohet se kjo do të paraqiste një barrë për të dhe për institucionin dhe nuk do t'i ndihmonte aspak proceset. Zgjedhjet u vëzhguan nga 3300 përfaqësues vendas dhe 520 vëzhgues të organizatave të huaja me ODIHR-in në krye. Qendrat e votimit u mbyllën në orën 19. Pjesëmarrja në votim e qytetarëve ka arritur në 44.4% këtë raund të dytë. Të dhënat janë regjistruar në orën 18.30, theksoi kryetari i KSHZ-së, Oliver Derkovski. Derkovski tha se zgjedhjet kaluan në një atmosferë të qetë dhe demokratike, me disa parregullsi të vogla. Në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale në Maqedoninë e Veriut, të dy kandidatët për president të Stevo Pendarovski, i mbështetur nga partitë e koalicionit qeveritar dhe Gordana Siljanovska-Davkova, e mbështetur nga opozita maqedonase u kanë bërë thirrje qytetarëve për dalje më të madhe në votime. Pendarovski dhe Siljanovska u përpoqën në prag të ditës së djeshme të votimit, që të bëjnë për vete votuesit e Blerim Rekës, i cili kishte rreth 80 mijë vota në raundin e parë. Në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, vëmendja është

drejtuar te dy partitë shqiptare në opozitë Aleanca për Shqiptarët e Ziadin Selës dhe Lëvizja Besa e Bilal Kasamit. Lëvizja BESA dhe Aleanca për Shqiptarët mbeten në qëndrimin e dhënë se nuk do të bëjnë tregti me votat e qytetarëve, të cilët në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale mbështetën konceptin e partive opozitare për kandidatë shqiptarë. "Lëvizja Besa nuk do të bëjë tregti me votat e dhëna në raundin e parë për mbështetje të konceptit të partive opozitare për kandidatin shqiptar prof. Blerim Reka. Nuk do të thërrasim në mbështetje të cilitdo kandidat që kaloi në raundin e dytë, por do të respektojmë vendimin individual të çdo votuesi për të shfrytëzuar të drejtën e votës", ka deklaruar nënkryetari i Lëvizjes Besa, Kastriot Rexhepi. Nga Aleanca për Shqiptarët shumica e anëtarëve të Kryesisë mbështesin qëndrimin e liderit të tyre, i cili disa herë ka përsëritur se nuk bën tregti me votat e shqiptarëve, dhe se ata janë pronarë të së drejtës së tyre dhe mund të votojnë sipas bindjes që kanë ata. "Do të lëmë votuesit vetë të vendosin se kë do të mbështesin në raundin e dytë", shprehet Flakron Bexheti, zëdhënës i Aleancës për shqiptarët.

Opozita shqiptare nuk duhet të jetë indiferente

Analisti Naser Selmani deklaroj në prag të votimit se opozita shqiptare nuk duhet të qëndrojë indiferente, por do të duhet të motivojë votuesit që të dalin dhe votojnë. "Ata kanë mundësinë që në mënyrë të heshtur me anëtarësinë e tyre, me strukturat e tyre të partive që t'i motivojnë për të dalë në votime. Nuk mund të pritet nga Aleanca dhe Besa që t'i kontrollojnë të gjithë ata 80 mijë votues që dolën dhe votuan Rekën. Nëse gjysma e tyre dalin në votim mendoj se do të kryejnë një punë të mirë", vlerëson Selmani. Profesori universitar Qashif Bakui konsideron se liderët opozitarë s'do të ndikojnë mbi elektoratin, ndërkaq një pjesë e mbështetësve të Rekës, në raundin e dytë do të përkrahin idenë proeuropiane, por

jo edhe kandidatin dhe partitë përreth tij. "Sa do të jetë ajo pjesë që do të dalë nga trupi votues i zotit Reka në zgjedhje mendoj se me afër qëndron kandidatit të LSDM-së, Pendarovski, jo se ata qëndrojnë më afër LSDM-së, por qëndrojnë më afër idesë proeuropiane", shprehet Bakui. Dalja e ulët e votuesve në raundin e parë për zgjedhjen e presidentit ka hapur debat se çfarë do të ndodhë nëse në raundin e dytë nuk arrihet pragu zgjedhor prej 40 për qind. Për t'i motivuar qytetarët që të dalin të votojnë më 5 maj, profesori universitar Temellok Risteski pati propozuar që të punohet më shumë me qytetarët dhe tyre t'u shpjegohej se zgjedhja e presidentit nga ana e tyre është në interesin e tyre. "Duhet të lëmë përsh-



typpë më të mirë tek miqtë e tanë të BE-së, duhet të lëmë përshlyetje se bëhet fjalë për shtet serioz, qytetarë serioz, të cilët mendojnë për të ardhmen e tyre. Duhet t'u shpjegohej qytetarëve se na është hapur rruga për BE dhe se anëtarësimi në BE do të thotë

perspektivë më të mirë dhe të ardhme më të ndritur", shprehet Risteski. Opinioni i Visar Ademi mendon se në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale nuk do të arrihet censusi, për shkak se njerëzit janë të lodhur me slogane dhe fasada. Gjithnjë, sipas Ademit qytetarët kërkojnë më tepër se sa BE-ja dhe Nato-ja. "Para disa muajve kemi bërë parashikimin pse censusi do të dështojë, tani ka një refleksim pas raundit të parë dhe unë mendoj se tre janë arsytet kryesorë: konotacionin mes LSDM-së dhe BDI-së, e dyta është figura problematike e Zoran Zaevit, që nuk ka një vazhdimësi të atyre që thotë, BE-ja, NATO-ja mund të bëjë që ta fitoni pushtetin, por pa patur një program real qeverisës nuk mund të vazhdoni për katër

vjet. Qytetarët kërkojnë më tepër se kaq, jo vetëm sloganë", thekson Ademi. Ish-kandidati për President, Agron Buxhaku thotë se shqiptarët në këtë raund të dytë do të jenë vendimtarë për fitoren e Presidentit të ardhshëm dhe se ata historikisht kanë votuar saktë, prandaj edhe këtë herë do të bëjnë të njëjtën gjë. "Shqiptarët votojnë matematikisht saktë, në momentin e duhur e japin votën atje ku duhet dhe shqiptarët e kanë kuptuar se krizat e reja nuk janë të nevojshme për shtetin, sidomos tani që kemi në prag të marrjes së datës për fillimin e negociatave", vlerëson Buxhaku. Për të pasur zgjedhje të suksesshme të presidentit të shtetit, sot më 5 maj është e nevojshme që në vendvotime të dalin të paktën 40 për qind e votuesve të regjistruar në Listën e vetme të votimit.

Vizita në Budapest, Orban përgatit aleancën me Salvini

Populistët bëhen bashkë, ç'pritet të ndodhë pas zgjedhjeve parlamentare të 26 majit

Gjatë vizitës së tij në Budapest, ministri i Brendshëm Salvini i premtoi kryeministrit hungarez Viktor Orban, një aleancë të vërtetë dhe besnike. Orban po përgatit daljen nga partia popullore europiane dhe deklaroi se pas zgjedhjeve parlamentare europiane të 26 majit do të vendosë se në cilin grupim politik do të rreshtohet. Matteo Salvini e Viktor Orban imagjinojnë një Europë të përbërë nga shtete - kombe të forta, kufij të mbyllur për emigrantët, pa kompetenca të Brukselit për sigurinë, marrëveshje tregtare dhe financiare të reja me vendet afrikane dhe aziatike të cilat nuk mundësojnë riatdhesimin e qytetarëve të tyre. Për të ndryshuar atë që kryeministri hungarez e kon-

sideron Europën e fjalëve boshe të Brukselit për populistët, në 26 maj - nga zgjedhjet europiane, duhet të lindë një mazhorancë e re. Një aleancë mes partisë popullore dhe të djathtës së re. Orban e thotë qartë: "Dëshiroj të dialogoj dhe të bashkëpunoj me persona dhe parti të forta me jetë, dhe që kanë mbështetjen e popujve të tyre, si miku im Salvini dhe partia e tij. Kryeministri hungarez i konsideron ata që në partinë popullore europiane e pengojnë, si parti të vogla pa vota të Europës Veriore. Parti që donin shkriren e partisë së tij duke e përjashtuar Fides. I quan të mbijetuar. Partia popullore europi-



ane nuk mund të jetë spital për politikanë të sëmurë në fazë përfundimtare. Është një betejë që zhvillohet e gjitha brenda Partisë Popullore Europiane ku kandidati kryesor Manfred Ueber nga Firenze u shpreh se Orban nuk ka fare

zë në këtë pjesë. Ndërsa nga Afrika Kancelarja gjermane Angela Merkel përjashtoi idenë e një marrëveshjeje mes populistëve dhe sovranistëve. Ministri i Brendshëm italian shpreson të sjellë në anën e tij populiste - sovraniste Orban, i cili tashmë është me një këmbë jashtë PPE-së. Pas zgjedhjeve parlamentare europiane, kryeministri hungarez do të vendosë se çfarë do të bëjë, në cilin grupim politik e parlamentar të Strasburgut do të vendosë euro-deputetët e tij. Sipas tij çdo gjë do të varet nga aleancat që do të krijojë partia popullore europiane. Nëse popullorët do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me so-

cialistët do të thotë se kanë zgjedhur të vetëvriten politikisht. Ndërsa për Salviniin aleanca mes socialistëve dhe demo-kristianëve do të transferonte Evropën në një Kalifat. Dita e takimit mes Orban dhe Salviniit nisi me një fluturim deri në Roeszke, fshat në kufi me Serbinë, i blinduar me 175 kilometra rrjetë metalike të lartë katër metra, disa prej të cilave të lidhura me elektricitet. Salvini shprehet se në Evropë mund të hyhet vetëm duke marrë leje, pasi ai synon një Europë ndryshe, që mbrohet sigurinë, punësimin, familjen dhe identitetin e krishterë të kontinentit. Salvini ndryshe nga Orban nuk flet për një rreshtim të së djathtës pasi thekson se përfaqëson një pozicion të fortë, alternativë të burokratëve, një lëvizje që nuk e sheh si të djathtë.

Dialogu Kosovë-Serbi, mendohet se do diskutohet në mbledhjen në Shqipëri

Vizita e Vuçiç në Tiranë, reagon Vetëvendosja: E presim me protesta!

8-9 maj pritët takimi i kryeministrit serb me Ramën e Mogherinin

Pasi u regjistrua në Tiranë disa ditë më parë, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje del me deklaratën e saj të parë, me anë të së cilës kundërshton vizitën e presidentit serb në Tiranë, Aleksandër Vuçiç. Reagimi vjen pas njoftimeve të datën 8 dhe 9 maj, Vuçiç do të jetë në Tiranë për të zhvilluar takime me kryeministrin Edi Rama dhe komisionerën e BE, Federica Mogherini. Në një deklaratë për mediat, Vetëvendosje argumenton se si presidenti Vuçiç ashtu edhe kreu i serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik janë njerëz që kanë mbajtur qëndrime antishqiptare. Vetëvendosje në Shqipëri paralajmëron edhe protesta, ndërsa në deklaratën e tyre theksohet: "Nëse Vuçiç është ftuar e do të vijë në Tiranë, me ose pa vëllain e politikave të tij ekstremiste, Dodikun, atëherë reagimi qytetar ka për të qenë i pashmangshëm".

DEKLARATA E PLOTË E QENDRËS SË LËVIZJES VETËVENDOSJE NË SHQIPËRI

Vuçiç nuk është i mirëpritur në Tiranë

Nga mediat dhe përfaqësues të huaj është raportuar se Aleksandër Vuçiç dhe Milorad Dodik do të vizitojnë Tiranën në datat 8 dhe 9 maj për të marrë pjesë në takimin "Brdo-Brione". Për këtë vizitë të tyre nuk ka patur asnjë njoftim zyrtar nga asnjë prej institucioneve të Republikës së Shqipërisë. Institucionet kanë zgjedhur heshtjen dhe mostransparençën, pikërisht në një periudhë kur Serbia synon haptazi ekspansion në Kosovë e në Bosnje. Vuçiç dhe Dodiku kanë gjetur bashkëpunorët për këto projekte supremaciste serbe edhe në mesin e pushtetarëve shqiptarë si Presidenti Hashim Thaçi, që si politikan ka marrë vazhdimisht përkrahjen nga Kryeministri Edi Rama, duke vendosur në rrezik interesat e gjithë kombit shqiptar. Mediat kanë raportuar gjithashtu se temë kryesore e kësaj vizite do të jetë dialogu Kosovë-Serbi. Kujtojmë se Ale-



ksandër Vuçiç ka qenë Ministër i Informacionit në qeverinë e Millosheviçit gjatë luftës në Kosovë. Që Vuçiç mbetet i njëjti, këtë e tregon edhe deklarimi i tij i kohëve të fundit se Millosheviçi ka qenë "një lider i madh". Ai dhe kabineti i tij qeverisës vazhdojnë të mohojnë sistematikisht masakrat e shumta që kanë ndodhur në Kosovë, 20-vjetori i të cilave po shënohet këtë vit për çdo javë në komunat e ndryshme të Kosovës. Vuçiç dhe Serbia nuk kanë kërkuar kurrë falje për krimet e tyre, nuk e njohin dhe e luftojnë pavarësinë e Kosovës, nuk kanë dënuar asnjë kriminel për 20.000 përdhunimet e grave shqiptare gjatë luftës, nuk i kanë kthyer mbi 1600 të pagjetur, nuk kanë paguar kurrë dëmshpërblimet e luftës, nuk kanë kthyer fondin pensional dhe

artefaktet e vjedhura kulturore, dhe vazhdojnë të shtypin për çdo ditë të drejtat politike e kulturore të shqiptarëve në Preshevë, Medvegje e Bujanoc që janë duke përjetuar edhe një gjendje të mjerueshme ekonomike. Për më shumë, Milorad Dodik drejton "Republika Srpska" që është themeluar mbi gjenocidin e Serbisë ndaj boshnjakëve. Vendimi i Tribunalit të Hagës për ta dënuar për krime lufte dhe gjenocid udhëheqësin e "Republika Srpska", Radovan Karaxinxhin, nuk vendosi drejtësi, pasi projekti i tij shoven mbijetojti dhe drejtohet sot nga Dodiku. Politikati e Dodikut janë arsyeja pse Bosnje Hercegovina është kthyer në një shtet që nuk funksionon normalisht, dhe që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Vuçiç dhe Dodiku janë ale-

atët kryesorë të Putinit në Ballkan, dhe mënyra se si Rusia tenton të shtrijë ndikimin e saj ushtarak, ekonomik dhe politik në rajon. Tarifa 100% ndaj mallrave të Serbisë është një mjet i pamjaftueshëm për të vendosur masat e reciprocitetit ndaj Serbisë, e cila praktikon ilegalisht "dumping" në Kosovë e Shqipëri, duke subvencionuar produktet e saj për t'i shitur nën çmimin e tregut, me synimin për të dominuar dhe shkatërruar produktin vendas shqiptar, e për pasojë ekonominë tonë kombëtare. Marrë parasysh luftën politike dhe kërcënimet e vazhdueshme ushtarake, bashkë me ofendimet e vazhdueshme, të qeverisë së Vuçiçit ndaj kombit shqiptar, masat e reciprocitetit ndaj Serbisë duhen shtuar dhe plotësuar, dhe jo hequr apo

PJESË E DEKLARATËS SË VETËVENDOSJES:

"Nëse Vuçiç është ftuar e do të vijë në Tiranë, me ose pa vëllain e politikave të tij ekstremiste, Dodikun, atëherë reagimi qytetar ka për të qenë i pashmangshëm."

pezulluar. Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Shqipëri i bën thirrje institucioneve të Republikës së Shqipërisë të sqarojnë menjëherë dhe publikisht se kush është ftuar e kush vjen në Tiranë në datat 8 dhe 9 maj, dhe cilat do jenë temat e këtij takimi. Ky sqarim nuk mund të zëvendësohet me fjalë si "janë ftuar liderët e Ballkanit", apo goftë edhe duke thënë se do të vijnë përfaqësues të BE-së, si Federica Mogherini, e cila ka mbajtur hapur një qëndrim në favor të politikave të Vuçiçit. Liderët e Ballkanit nuk janë të njëjtë në raport me shqiptarët dhe Shqipërinë, dhe prandaj nuk mund të trajtohen të gjithë njëjlojt nga shteti shqiptar. Nëse Vuçiç është ftuar e do të vijë në Tiranë, me ose pa vëllain e politikave të tij ekstremiste, Dodikun, atëherë reagimi qytetar ka për të qenë i pashmangshëm.

SHKURT

Përplasja në Rripin e Gazës, 9 viktima dhe dhjetëra të plagosur

Gjatë natës së ditës së shtunë, është bërë një goditje me raketa drejt objektivave të Hamasit në Gaza. Ushtria izraelite u kundërpërgjigj sulmeve të vazhdueshme të organizatës ekstremiste që nisën prej të premtes. Bilanci i sulmeve është 9 të vdekur dhe dhjetëra të plagosur mes të dyja palëve. Mes të vdekurve vetëm 1 është në radhë e Izraelit, një banor 58-vjeç i Ashkelonit në jug të Izraelit, banesa e të cilit u godit gjatë natës nga raketat e hedhura nga Hamasit. Ekstremistët palestinezë kanë hedhur 430 raketa në drejtim të Izraelit, prej të premtes. Një pjesë e tyre janë kapur nga mbrojtja rakitore izraelite "Iron Dome". Izraeli është kundërpërgjigjur me raketa e bombardime me avionë, duke shkatërruar mbi 200 objekte të Hamasit. Përplasjet nisën prej të premtes kur militantët të Hamasit plagosën dy ushtarë izraelitë në kufirin jugor, pas bllokimit nga Izraeli të një korridori ku dysohej se ekstremistët trafikonin armë. Këto konsiderohen si përplasjet më intensive të javëve të fundit.

Kongo, vazhdon përhapja e ebolës

Federata Ndërko mbetare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmehënës së Kuqe thotë se epidemia e ebolës në Republikën Demokratike të Kongos po keqësohet dhe deri tani ka vrarë mbi 1000 vetë. Federata tha sot se gjatë javës së kaluar janë diagnostikuar 23 raste të reja, një numër rekord që nga epidemia shkatërrimtare e vitit 2018. Dhuna në rajon ka penguar përpjekjet për të vënë nën kontroll epideminë e dytë më të rëndë në histori të kësaj sëmundjeje virale. Mjekimet dhe puna parandaluese për momentin nuk po ecin me ritmet e nevojshme. Shumë njerëz nuk shkojnë në klinika pasi i tremben dhunës. Personat e infektuar preferojnë të qëndrojnë në shtëpi, ku rrezikojnë edhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Punonjësit e shëndetësisë parashikojnë intensifikimin e rritmeve të përhapjes së infeksionit. Në përhapjen e saj më të rëndë në 2014, ebola vrau 11 mijë vetë brenda dy vjetësh në Afrikën Perëndimore.



MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Njihuni me efektet
e bimës së dranakuqit
në trupin tuaj

KESHILLA



7 mrekullitë
e avokados
në trupin
e njeriut

Sotiraq Lako:



◆ Mjeku
hematolog:
Antiagreguesit
dhe
antikoagulantët,
ja kur mund
të shkaktojnë
hemorragji

“Holluesit e gjakut” në praktikën e përditshme mjekësore

“Funksioni real i këtyre
preparateve në organizëm”

• Tërshëra, ushqimi plot fibra që zhdok urinë me “magji”

Mjeku hematolog: Antiagreguesit dhe antikoagulantët, ja kur mund të shkaktojnë hemorragji

Sotiraq Lako:

"Holluesit e gjakut" në praktikën e përditshme mjekësore

"Funksioni real i këtyre preparateve në organizëm"

Voltiza Duro

Antiagreguesit, të njohur ndryshe si holluesit e gjakut, janë preparate që veprojnë në hemostazën primare, e pengojnë agregimin e trombociteve. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku hematolog, Sotiraq Lako tregon se asnjë nga preparatet antiagreguese dhe antikoagulante nuk e hollon gjakun në kuptimin e vërtetë të tij. Ai shton se preparatet e sipërpërmendura veprojnë në faza të ndryshme të Hemostazës, që është "një proces kompleks, që normalisht aktivizohet menjëherë pas dëmtimit të murit të vazës (vazave) të gjakut dhe që siguron ndërprerjen e rrjedhjes së gjakut (hemorragjinë) dhe më pas rivendosjen e qarkullimit në këtë vazë (vaza) pas rindërtimit të dëmtimit. Lako thekson se antiagreguesi apo antikoagulanti shkaktojnë hemorragji, kur të paktën është dëmtuar paraprakisht mucoza (dhe çdo shtresë tjetër më dëmtim të vazave të gjakut) për faktorë patologjikë, jatrojenikë. Vetëm Aspirina mund të dëmtojë drejtpërdrejtë mucozën gastrike, kur merret nga goja.

A mund të përdoret aspirina si një hollues gjaku?

Po nisem nga një rast i praktikës tonë klinike. Pacienti përdorte Aspirinën si "hollues të gjakut" dhe ishte i shqetësuar se nuk po i ullej nivelin e Protrombinës (ritej

INR). Është e vështirë për t'ia shpjeguar që me përdorimin e Aspirinës si antiagregues, nuk presim që të ndryshojë Niveli i Protrombinës (INR). Në praktikën tonë klinike, në kushte të caktuara si mjekim dhe parandalim, jemi të detyruar të përdorim "holluesit e gjakut", antiagreguesit dhe antikoagulantët, veçmas ose në kombinim midis tyre. Dhe në literaturën e huaj gjendet termi "Blood Thinner". Në fakt, ky term përdoret që pacienti ta ketë më të lehtë për të kuptuar problemin, por e vështirëson punën tonë.

A ndodh realisht hollimi i gjakut në momentin që pacienti

përdor preparate antiagreguese dhe antikoagulante?

Asnjë nga këto preparate antiagreguese dhe antikoagulante nuk e hollon gjakun në kuptimin e vërtetë të tij. Nëse ke një përzierje të 1 kg oriz me 1 kg ujë dhe synon hollimin, ose duhet të shosh ujën për të njëjtën sasi orizi, ose të pakësosh sasinë e orizit për të njëjtën sasi uji. Këto preparate as nuk ndryshojnë numrin e qelizave të gjakut, as ndryshojnë volumin e plazmës, pra nuk shkaktojnë "Hollimin e Gjakut". Ato veprojnë në faza të ndryshme të Hemostazës, që është "një proces kompleks, që normalisht aktivizohet menjëherë pas



Mjeku hematolog, Sotiraq Lako

dëmtimit të murit të vazës (vazave) të gjakut dhe që siguron ndërprerjen e rrjedhjes së gjakut (hemorragjinë) dhe më pas rivendosjen e qarkullimit në këtë vazë (vaza) pas rindërtimit të dëmtimit. Ajo përfshin ndërveprimet e enëve të gjakut (strukturat e mureve të gjakut dhe qelizave endoteliale që veshin nga brenda këto enë) dhe gjakut (trombocitet dhe faktorët e koagulimit).

Cilat janë etapat e hemo-

stazës?

Për lehtësi studimi Hemostaza ndahet në 3 etapa (ndarje me qëllim studimor, sepse të gjithë procesi i hemostazës është në vazhdimësi):

Hemostaza primare që ka përbërësit kryesorë, vaza e gjakut dhe trombocitet (numri dhe funksioni) me synimin, ngushtimin e vazës formimin e trombosit trombocitar (që në të vërtetë akoma nuk është i qëndrueshëm). Kontrollonhet me numrin e trombociteve, funksionin e tyre, Koha e Hemorragjisë (2-4 minuta). Etapa e dytë është koagulimi (Hemostaza Sekondare) ku faktorët e Koagulimit që aktivizohen njëri pas tjetrit (Rruga e Brendshme, Rruga e Jashtme, Rruga e përbashkët e Koagulimit) me synimin përfundimtar shndërrimin e Fibrinogjenit në Fibrinë, rrjetë që i vendoset sipër trombit trombocitar dhe siguron qëndrueshmërinë e tij. Testet me të zakonshme për kontrollimin e kësaj faze janë: PT/INR (Rruga e Jashtme), APTT (Rruga e Brendshme), Fibrinogjeni (dhe Koha e Trombinës) për Rrugën e Përbashkët të Koagulimit. Mund të maten dhe faktorët e koagulimit veç e veç. Rëndësi ka vlera normale (të paktën optimale) dhe funksioni i tyre. Tradicionalisht është përdorur dhe Koha e Koagulimit (4-6 minuta), por që ka vlerë (del më e zgjatur) kur niveli plazmatik i faktorit/faktorëve është shumë i ulët (<1%). Ndërsa etapa e tretë është fibrinoliza. Pasi ndalohe hemorragjia dhe riparohet muri i dëmtuar i vazës së gjakut, synimi është





të shkrirja e trombit dhe rivendosja e qarkullimit në këtë vazë. Aktivizimi i Fibrinolizës siguron zbërthimin e rrjetës së fibrinës dhe për rrjedhojë dhe të trombit tromboticitar. Testi më i zakonshëm në praktikën klinike (ka dhe teste specifike për këtë fazë) është matja e D-dimër.

Cilat janë testet që përdoren për vlerësimin e hemostazës?

Testet rutinë, që përdoren në praktikën tonë klinike për vlerësimin e Hemostazës: Tromboticit (numri), Koha e hemorragjisë (2-4 minuta), PT/INR, APTT, Fibrinogjeni. Tre testet e fundit, quhen dhe "Testet e Përgjithshme të Hemostazës". Duhet theksuar se pjesa më e rëndësishme e faktorëve të koagulimit, prodhohen në mëlçi dhe në mënyrë empirike të gjithë vlerësojnë transaminazat dhe bilirubinën. Nëse niveli plazmatik i Fibrinogjenit (Faktori I i koagulimit) është normal, funksioni hepatic është i ruajtur.

Ç'kuptojmë e gjakut të antiagregues dhe antikoagulant?

Antiagreguesit janë preparate që veprojnë në Hemostazën Primare, pengojnë agregimin e trombociteve, pra lidhjen midis trombociteve që janë ngjitur tek zona e dëmtuar e vazës së gjakut. Por nuk kanë ndikim në numrin e tyre (të trombociteve) dhe asnjë ndikim në fazat e tjera (Koagulimi dhe Fibrinoliza). Antikoagulantët janë preparate që ndikojnë në faza të ndryshme të Koagulimit (Fazës së dytë), pa ndikuar në sasinë e tyre, por në funksionin (aktivitetin) e tyre. Nuk ndikojnë në dy fazat e tjera (Hemostazën Primare, Fibrinolizë). Në kushte spitalore, përdoren dhe fibrinolitikët (për shkrirjen e trombeve) dhe preparatet antifibrinolitike.

Cilët janë holluesit e gjakut që përdoren në vendin tonë?

Si antiagreguesit më të zakonshëm që përdoren në kushte spitalore dhe ambulatorisht janë: Aspirina dhe Plavix (Clopidogrel). Efekti i tyre është i pakthyeshëm, pra do të zgjasë sa kohë jeton trombociti; 8-10 ditë. Që do të thotë; nëse sot i ndërpre, efekti i tyre do të zgjasë deri sa të vdesë dhe trombociti i fundit me funksion të bllokuar prej tyre (8-10

ditë), duke mos harruar që vazdimisht prodhohen trombocite të reja që nuk e kanë funksionin e bllokuar përdorisë preparati antiagregues nuk përdoret më (duke pretenduar që dhe të jetë eliminuar nga organizmi). Prandaj përpara një ndërhyrje kirurgjikale të planifikuar (ose procedura të tjera invazive), ato ndërprehen disa ditë më parë. Nuk ndikojnë në numrin e trombociteve, me përjashtim të rasteve të veçanta si efekte anësore. Nuk ka antidotë për to (në rast nevojë të përdoren masa trombocitare me efikasitet të kufizuar: dhe trombociteve që

përdorimit të antikoagulantëve?


Heparina përdoret vetëm në kushte spitalore, kështu që kontrolli i saj është shumë më i mirë. Vlerësohet efekti duke matur APTT. Ka antidotë (Protamina) dhe për më tepër T ½ (gjysmë jeta plazmatike) e Heparinës është e shkurtër (2 orë). Monitorohen trombocitet, për shkak se disa raste mund të shkaktojnë HIT (Trombocitopeni i Induktuar nga Heparina), komplikacion. Heparinat me Peshë të Vogël Molekulare (LMËH) - janë disa. Më shpesh në praktikën tonë përdoret (në kushte spitalore dhe ambulatorisht) Enoxaparin (Clexane) Nuk

VII, IX, X, Proteinën C dhe S. Me tepër ndihet efekti mbi Faktorin VII, që ka gjysmëjetën plazmatike më të shkurtër. Nuk ndikojnë në sasinë e prodhimit, vetëm në mosaktivizimin e tyre. Efekti shfaqet pas 2-4 ditësh dhe po pas kaq ditësh eliminohet. Monitorohen me Nivelin e Protrombinës (PT/INR). PT duhet mbajtur 25-35 % (INR 2-3). Nëse PT < 20 % (INR > 6) ka rrezik të fenomeneve hemorragjike. Ndërpritet preparati (duke mbajtur mënd që efekti vazhdon dhe 2-4 ditë të tjera). Antidoti është Vitamina K që kur merret nga goja e shfaq efektin pas 12-24 orësh dhe kur merret intravenoz minimumi do të vlerësohet pas 1-2 orësh dhe niveli normal i PT (INR) pas 12-14 orësh, prandaj në rast urgjence, përdorimi i gatshëm i faktorëve të koagulimit të aktivizuar (transfuzioni i plazmës, apo i faktorëve të gatshëm si Prothrombin Complex Concentrate) sipas protokolleve të standardizuara. Në rast se ka rritje të INR, pa klinikë (hemorragji), do të ndërpritet preparati dhe në rast se sasia e faktorit/faktorëve të koagulimit të prodhuara nga mëlçia është normale, nuk ka konsum të tyre në qarkullim, sasia e Vitaminës K është e adekuatë (ose e mbishtojmë si terapi), mund të pritet derisa të eliminohet efekti i preparatit.

Cilët janë antikoagulantët oralë jo antivitaminik K?

Efekti i Vitaminës K merret në rastin më të mirë pas 12 orësh kur me të vërtetë shkaku i hemorragjisë është i lidhur me mungesën ose antagonizimin e saj, kështu që mos pretendoni kur kenë një gjakrrjedhje dhe shkoni në një shërbim mjekësor dhe ju bëjnë Vitaminë K (akoma më keq intramuskular) t'ju ndalojë menjëherë hemorragjinë (siç ndodh rëndom në vendin tonë).

Nëse PT mbahet nën mjekim 25-35 % dhe një njeri e ka PT 50 % dhe ka hemorragji p.sh nga hunda, nuk e ka hemorragjinë nga niveli më i ulët i PT në krahasim



transfuzohen, nëse preparati është akoma në qarkullim, mund të bllokohet funksioni). Efikasiteti i këtyre preparateve matet me anë të Tromboelastografisë, që nuk përdoret në vendin tonë. Në mënyrë indirekte i vlerësojmë me Kohën e Hemorragjisë (tek veshi), që në normë është 2-4 minuta dhe po që më e zgjatuar (gjithmonë kur bëhet nga një specialist i mirë-filltë), mund të vlerësohet e ndikuar nga këto preparate. Sasia minimale e Aspirinës për të marrë efektin antiagregues është 75 mg/ditë.

Mund të na tregoni se cilët janë faktorët që aktivizohen pas

kanë asnjë markues për t'i ndjekur në vendin tonë (përdoret matja e anti-factor Xa në laboratorët e specializuar). LMWH kanë T ½ 12 orë, nuk kanë antidotë. Monitorohen trombocitet, për shkak se disa raste, shumë më të rralla se Heparina, mund të shkaktojnë HIT (Trombocitopeni i Induktuar nga Heparina), komplikacion.

Antikoagulantët Oralë përfshijnë Antivitaminikët K (Sintrom dhe Warfarin (Coumadin)) që përdoren në praktikën tonë spitalore dhe ambulatorie. Efekti i tyre lidhet me antagonizimin (frenimin) e Vitaminës K që aktivizon faktorët e koagulimit II,

me normën (70-120%). Hemorragjia mund të justifikohet kur PT < 20 % (INR >6). Të shikohet për faktorë të tjerë lokal (vaza e gjakut) etj.

Frenuesit Direkt të Faktorit X të Aktivizuar (Rivaroxaban - Xarelto), ka filluar të përdoret rregullisht për të zëvendësuar Sintromin dhe Warfarinën. Nuk monitorohet PT/INR, nuk ndikohet nga ushqimet. Nuk ka antidotë. Eliminohet shpejt. T ½ e eliminimit 5-9 orë tek moshat 20-45 vjeç dhe 11-13 orë tek moshat 60-76 vjeç. Rrallë, në kushte spitalore, në rast HIT dhe nevojë për të vazhduar antikoagullimin, përdoren Frenuesit Direkt të Trombinës. Për kuriozitet e kanë origjinën nga Hirudo medicinalis - shushunjat, që prodhon peptidin hirudin nga gjendrat e pështymës, me afekt antikoagulant.

A janë të rrezikshëm holluesit e gjakut?

Siç e shpjeguem më sipër, asnjë nga "holluesit e gjakut", nuk shkakton hollimin në kuptimin e vërtetë të gjakut, pra nuk shkaktojnë "anemi nga hollimi", problem që e hasim shumë në praktikën tonë klinike. Me përjashtim të Aspirinës që mund të dëmtojë vazat e gjakut në Aparatin Gastro-Intestinal dhe shkakton hemorragjinë përkatese (Aspirina = Acidi Acetilsalicylik, pra rrit aciditetin e stomakut, për rrjedhojë dhe rrezikun e ulçerave), asnjë nga preparatet e tjera "holluese të gjakut", nuk shkakton hemorragji. Hemorragjia ndodh vetëm kur dëmtohet vaza e gjakut (spontane, traumë, kirurgji) dhe për rrjedhojë të faktit që funksioni i përbërësve të hemostazës (hemostazës primare nga antiagreguesit dhe hemostazës sekundare nga antikoagulantët, apo i të dyjave kur kombinohen) është i bllokuar (në varësi të preparatit apo preparateve të përdorura), do të ketë gjakrrjedhje të shtuar dhe të zgjatur dhe që kërkon ndërhyrje mjekësore (sipas protokolleve të caktuara). Antiagreguesi/antikoagulantit shkaktojnë hemorragji, kur të paktën është dëmtuar paraprakisht mucoza (dhe çdo shtresë tjetër më dëmton të vazave të gjakut) për faktorë patologjikë, jatrogjenikë. Vetëm Aspirina mund të dëmtojë drejtëpërdrejtë mucozën gastrike, kur merret nga goja. APTT dhe PT në mënyrë indirekte vlerësojnë nivelin plazmatik dhe aktivitetin e faktorëve përkatesë të koagulimit. Kujdes në Diatetë hemorragjike - vëf dhe Faktori XIII dhe në rast se të gjitha janë normale. Për faktorë të veçantë duhet të bëjmë nivelin dhe aktivitetin.

Voltiza Duro

Bima e dranakuqit e njohur ndryshe me emrin Rhamnus frangula L, është një shkurre e përhapur në Shqipëri dhe rritet në toka argjilore-silicore, zakonisht në pyje me lagështi. Për përdorim mjekësor mblihen lëvoret e trungut dhe të degëve në periudhën e pranverës. Bima e dranakuqit duhet tharë në hije dhe në vend me temperature të lartë, që të nxitet prodhimi i përbërësve kimikë që forcojnë efektin e bimës.

Përbërësit kimikë

Bima e dranakuqit përmban glikozide hidroksiantra kinonike (3-8%), që janë mono dhe diglikozide të frangula e modinës, përbërës të cilat i japin veti të laktative të kësaj bime. Këta përbërës nuk përthithen në pjesët e sipërme të zorrëve, por hidrolizohen më pas nga flora bakteriale, duke dhënë metabolitë farmakologjikisht aktivë. Drugulinat nuk gjenden në bimë, por formohen gjatë ruajtjes. Pra sa më e vjetër të jetë bima aq më të forta janë këto përbërës, dhe aq me efektive është bima.

Vetitë e bimës

Lëvorja e dranakuqit përdoret për veprimin e saj laksativ. Kjo bimë ndihmon që uji të dalë nga qelizat e zorrës, ndihmon lëvizjen e zorrës dhe kështu shtyhet masa e feçes. Dranakuqi nuk ka efekte anësore të dëmshme si bimë të tjera laksative, pasi nuk shkakton dëmtime në zorrë, megjithatë nuk duhet përdorur pa ndërprerje pasi e bën zorrën dembele. Gjithashtu, vlen të theksoj se kjo bimë ndihmon për rënien në peshë, dhe në largimin e celuliteve. Dranakuqi ndihmon në tretjen e yndyrave nën lëkurë, dhe kështu heq celulitin.

Doza ditore dhe afati i përdorimit

Doza ditore e bimës është 1 gotë çaji me bimën e dranakuqit. Kështu merret 1 lugë gjelle me këtë bimë, zien në 2 gota ujë dhe pihet 1 gotë në ditë përpara gjumit. Bima vepron për 5-6 orë në jashtëqitje.

Përgjithësisht, nuk rekomandohet përdorimi mbi dy javë resht, pa ndërprerje.

Efektet anësore

Dranakuqi nuk duhet të përdoret nga individët me bllokim ose ngushtim të zorrëve, në sëmundje inflamatore, si p.sh. në kolit ose në sindromën e zorrës së irrituar, në apendisit apo në konstipacion kronik. Përdorimi i vazhdueshëm mund të çojë në prishje të ekuilibrit të elektrolitëve dhe në rëndimin e gjendjes së konstipacionit.

Trajtimi i majasëllit

Majasëlli nuk është gjë tjetër veçse zgjerimi i venave të zorrës së trashë. Nga majasëlli preken më



Mjeku popullor: Kujdes, bima nuk duhet përdorur nga të sëmurët me kolit

YLLI MERJA: Njihuni me efektet e bimës së dranakuqit në trupin tuaj "Ndhmon veprimtarinë e zorrës dhe zhduk celulitin"



Mjeku popullor Ylli Merja

shumë njerëzit që bëjnë jetë të ndenjor dhe që merren shumë pak me punë aktive. Kjo është një sëmundje mjaft e shpeshtë, që te gratë arrin deri në 70% të preksshmërisë.

Dallojmë Majasëll të brendshëm, ku nyjet e venave të zgjeruara janë në thellësi dhe nuk shihen me sy dhe majasëlli i jashtëm ku ato dalin jashtë anusit. Majasëlli mund të shkaktohet nga kapsllëku kronik, mbiushqyerja, jeta e ndenjor, sëmundjet e mëlçisë se zezë, sidomos cirroza, pamjaftueshmëria e punës së zemrës, presioni i shtuar në pjesën e poshtme gjatë bar-

rës apo tumoret e zorrës së trashë.

Ndalohen ushqimet ngacmuese, pikante, alkooli, piperi i kuq dhe i zi, salca apo mishi i derrit. Këshillohen ushtrime gjimnastikore, shëtitjet, masazhet e barkut, të luftohet jeta pasive. Bari i Majasëllit dhe i kolitit kanë dhënë rezultate të mira në gazrat, shfryrjet e zorrëve, në spazma etj. Pra, ka edhe shumë bimë të tjera si: Kamomili, frutat e Gështenjës së Egër, Bishtamidhi, Manaferra, Rigonit. Merrni 40gr prej tij, ziejeni me 1 litër ujë për 1 orë e gjysmë dhe pini 1 filxhan para buke, 3 herë në ditë. Bishtat e disa patëllxhanave të karbonizohen në furrë të

sobës derisa të bëhen pluhur. Me këtë merret dhe përzihet mjalti dhe vendoset në garzë sterile poshtë në anus. Ajo qetëson dhimbjet dhe përmirëson dukshëm hemorroidet nga poshtë. Merrni një lugë gjelle me sytha të njoma plepi, të thahen dhe kavardisen në tigan, pastaj përzihet pluhuri me vaj ulliri. Me këtë pomadë lyhet rreth e qark anusi duke e mjekuar në mëngjes dhe darkë. Merrni 5 lugë gjelle lëvore dranakuqi të mbledhura para se të çelë gjetet. Hidheni në 1 litër ujë dhe ziejeni 10-15 minuta. Ena lihet e mbuluar 20-30 minuta, pastaj kullohet. Pihet 1 gotë para gjumit. Kur acarimi arrin kulmin, aq sa i sëmurit nuk mund të qëndrojë dot ulur, merrni 40 thelpinj nga bërthama pjeshkash dhe i kavardisni si kafe.



Këshilla

7 mrekullitë e avokados në trupin e njeriut

Avokadoja është një frutë ekzotike, me dukje të paza konshme që përngjason me dardhën. Ka lëkurë ngjyrë të gjelbër, por edhe brendinë të butë dhe të shijshme të pasur me vitamina, minerale dhe me nutrienë të tjerë. Konsumimi i saj është i pakët dhe kjo për faktin se ndoshta më parë nuk kemi qenë në dijeni të përfitimeve shëndetësore që mund të marrim nga konsumimi i saj. Më poshtë po paraqesim disa prej efekteve të mrekullueshme që avokadoja ka në organizmin e njeriut:

Parandaluese e tumoreve

Avokadot kanë treguar se parandalojnë rritjen e kancerit të prostatës dhe kancerit të gjirit.

Mbron sytë dhe ul kolesterolin
Avokadot kanë më shumë luteinë karotenoid se sa çdo frutë tjetër e konsumuar. Luteina mbron sytë nga dobësimi dhe nga sëmundjet e moshës.

Mban zemrën e shëndoshë

Një avokado ka 23 për qind të vlerës së rekomanduar ditore në folate. Studimet tregojnë se njerëzit që hanë ushqime të pasura me folate kanë një nivel shumë më të ulët të sëmundjeve të zemrës se sa ata që nuk e bëjnë këtë.

Nxit rregullimin e sheqerit në gjak

Një nga aftësitë që ka avokadoja është se ndërhyr në rregullimin e nivelit të karbohidrateve dhe sheqerit në gjak. Në përgjithësi avokado është ushqim që përmban një sasi të pakët sheqeri dhe karbohidratesh, në të njëjtën kohë një gotë avocad përmabn 7-8 gramë fibra, të cilat



janë thelbësore për rregullimin e sheqerit në gjak.

Kurë natyrale për artritin

Artriti përfshin osteoartritin dhe artritin reumatoid. Kërkuesit kanë dalë në përfundimin se avokado ka aftësi të lehtësojë simptomat e artritit për shkak të përbërësve që ajo ka.

Është plot me fibra

Fibra ndihmon me rënien në peshë, ul nivelin e sheqernave në gjak dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me uljen e rrezikut ndaj një sërë sëmundjesh.

Flokë, lëkurë dhe thonj

Fibra ndihmon me rënien në peshë, ul nivelin e sheqernave në gjak dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me uljen e rrezikut ndaj një sërë sëmundjesh.

të shëndetshëm

Avokado është një alternativë e mrekullueshme për ta zbukuruar trupin pa kimikate. Ajo ndihmon që flokët, lëkura dhe thonjtë tuaj të jenë të shëndetshëm dhe të bukur.

Përgatitja

Avokadon mund ta hani të njomë, të prerë në feta. Për shije më të mirë shtoni pak lëng limoni apo uthull balsamica. Mund ta përgatitësh edhe si lyerje apo si salcë. Ky frut është shtojcë shumë e shëndetshme për çdo ushqim, nevojitet vetëm pak imagjinatë se si ta përfshini në çdo racion.



Tërshëra, ushqimi plot fibra që zhduk urinë me "magji"

Tërshëra është një ushqim mjaft i lehtë dhe me vlera të mëdha ushqimore në të njëjtën kohë. Ajo ndihmon për të kontrolluar nivelin e sheqerit në gjak. Mund të përdoret nga të gjithë, nga fëmijët, nga të moshuarit dhe nga personat që merren me aktivitetet sportive. Ky lloj ushqimi largon urinë, simptomat e lodhjes, ndihmon në funksionin e duhur të zorrëve dhe ul rrezikun e sëmundjeve koronare të zemrës. Ja se si mund ta përdorni në jetën e përditshme nga vakti i mëngjesit deri tek maskat e bukurisë:

SI VAKT MËNGJESI

Prej shekujsh, në Europën Veriore, tërshëra gjithmonë është përdorur për të përgatitur qullin e famshëm, që është i njohur në gjithë botën. Por mund ta përdori edhe në mënyra tepër të thjeshta. Në një enë hidhni tërshërë, qumësht ose kos, shtoni fruta të thata, por më shumë shkon me boronicën. Një pjatë tepër e shijshme për mëngjesin tuaj. Tërshëra ka aftësi që t'ju largojë urinë, sepse në qoftë se e hani për mëngjes, nuk do t'ju duhet të hani më para vaktit të drekës. Ajo këshillohet edhe për personat që mbajnë diete, duke u përdorur me kos dhe fruta të thata.

PËRFITIMET NGA TËRSHËRA

Të konsumojmë tërshërë ose miell tërshërë bën shumë mirë për tretjen. Në sajë të përmbajtjes së lartë të fibrave në të, ndihmon personat që vuajnë nga kapllëku, ata që vuajnë nga refleksi, ndihmon reduktimin e kolesterolit në gjak dhe ul rrezikun e infarkteve. Gjithashtu, mund të përdoret për të ulur aciditetin në trup, duke e përdorur vetëm me ujë.

E "EMBËL" NË LËKURË

Mund të përdoret si maskë bukurie, sepse tërshëra zbut dhe mbron lëkurën. Në një gotë hidhni ujë ose qumësht të ngrohtë, një lugë gjelle miell tërshërë dhe një lugë kafe mjaltë. Më këtë masë masazhoni mirë fytyrën për disa minuta. Mund të përdoret dhe si skrap për trupin. Në një enë hidhni tërshërë, disa lugë gjelle vaj sipas dëshirës, si vaj argani, vaj bajame, vaj kokosi ose vaj ulliri, më pas shtoni sheqer ose kripë. Me këtë masë lyeni të gjithë trupin tuaj nga qafa tek këmbët, mbajeni 15 minuta pastaj shpëlaheni. Ky skrap është mjaft i mirë kundër tharjes dhe skuqjes së lëkurës.

PRONARET KOMPENSIMI

Ndërtimet pa leje, marrin tapitë për truallin 1000 përfitues, sipërfaqet që legalizohen

Agjencia e Kadastrës, 105 milionë lekë për 300 pronarë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër

Qeveria miraton një fond prej 105 milionë lekësh për kompensimin e 300 pronarëve, që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Në të njëjtin vendim është miratuar edhe kalimi i pronësisë për truallin mbi të cilin është ndërtuar. "Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas Zyrrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme është 10 993,97 m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 105 224 873 lekë", thuhet në vendim. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare dje. Ndërkohë është miratuar kalimi i së drejtës së pronësisë, në favor të sub-

jektëve përfituesë, për 633 prona me rreth 1000 pronarë. Vlera kompensimit financiar për pasuritë vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronës, e cila bën të ditur listën me përfituesit.

TAPITË

Këshilli i Ministrave

miratoi të mërkurën edhe kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre. Sipas vendimit të qeverisë, mësohet se për qarkun Elbasan (ZVRPP

Elbasan, Peqin, Librazhd), janë pajisur me tapi 163; për qarkun Durrës (ZVRPP Durrës), 24; për qarkun Tiranë (ZVRPP Tiranë dhe Kavajë), 174; për qarkun Fier (ZVRPP Lushnjë), 20, për Shkodrën 9; për qarkun Vlorë (ZVRPP Vlorë dhe Sarandë), 186; për qarkun

Gjirokastrë 45; për qarkun Lezhë 9; për qarkun Kukës dhe për qarkun Korçë nga një. Këshilli i Ministrave urdhëron Zyrrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë,

Gjirokastrë, Kavajë dhe Kukës të regjistrojnë brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

(Vijon nga nr. i kaluar)

QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_1066						
187	BASHKIM	KADRI	KANANI	70208027	12/6/2017	TE
188	AZGAN	ALI	DUSHAJ	70203784	6/7/2016	SHTETER ORE
	ARIF	ALI	DUSHAJ			
189	JANI	JORGO	AGORA	70204170	28/07/2016	SHTETER
190	BUJAR	BILBIL	JATA	70201065	7/1/2016	SHTETER
191	ANTON,KOL	KOL,SOKO	ZHABORJA	70203890	13/07/2016	SHTETER
192	LUTFI	MUSTAFA	BALLGJINI	70209777	29/03/2018	SHTETER
193	SULEJMAN	ISMAL	KURTI	70209690	27/03/2018	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_1514						
194	PERPARIM	XHELAL		70209226	1/12/2017	TE
195	HANE	AHMET	KOLOSHI	70208029	13/06/2017	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_2884						
196	MUSTAFA	HAZIS	FISHTI	70209658	26/03/2018	SHTETER
Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						
Nr. rendor	Emër	Atësi	Mbiemë r	Leja e legalizimit		Pjesa takuese në parcelë
				Numer	Date	
1	2	3	4	5	6	7
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_3993						
197	PERPARIM SEKMAN	RAHMAN	NESIMI	70209198	30/11/2017	PA INFO
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_2066						
198	FATMIR	HYSEN	SHUPLI	70209224	20/11/2017	SHTETER
199	SHKELQIM	KAPLLAN	BRAHLIK	70209526	20/03/2018	SHTETER
200	FILIP	PJETER	PROGNI	70209699	27/03/2018	SHTETER
201	TEME	MEHMET	PELUSHI	70208866	18/10/2017	SHTETER
202	ZARIE	SHERIF	MARKU	70203719	30/06/2016	SHTETER
203	SALI	MAHMUT	NOKA	70203819	18/07/2016	SHTETER
204	DAN	MEHMET	HIDRI	70203874	12/7/2016	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_3992						
205	ARBRI	SADIN	SAVA	70209211	30/11/2017	SHTETER
206	KUJTIM	NEZIR	KURTI	70209759	28/03/2018	SHTETER
207	LIRIE	ADEM	KURMETA	70207118	27/03/2017	SHTETER
208	AGRON,MERI	JAKUP	REXHMAT	70209222	30/11/2017	SHTETER
209	MELAIM	SHABAN	DELIHAS	70209780	29/03/2018	SHTETER
210	SHKELZEN	SADIN	SAVA	70209665	22/02/2018	SHTETER
211	TAF	RRUSTEM	AHMATI	70205155	20/10/2016	SHTETER
212	GASPER	MITER	PRABIBA	702010358	24/05/2018	SHTETER
213	SAMI	SHAQIR	BRAKA	70203846	11/7/2016	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_2726						
219	VEBI	HASAN	MATRAN	70207181	29/03/2017	TE

QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_2372						
220	BARDHYL	MYFTAR	KOÇI	70204954	30/09/2016	SHTET(27)
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_3554						
221	RIZA	BANUSH	MISIRI	70208704	28/09/2017	TE
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_3127						
222	VATH	ALI	TARJA	70201109	26/01/2016	SHTETER
223	TOM	MARK	PERKEQI	70201107	26/01/2016	SHTETER
Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					
	Emër	Atësi	Mbiemë r	Leja e legalizimit	Date	Pjesa takuese në parcelë
1	2	3	4	5	6	7
224	HAXHI	XHAFAER	DEMIRXHIU	70204153	27/07/2016	SHTETER
225	BESNIK	FEIM	DOKA	70203198	23/05/2016	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_2066						
226	ZARIE	SHERIF	MARKU	70203719	30/06/2016	SHTETER
227	SALI	MAHMUT	NOKA	70203819	18/07/2016	SHTETER
228	DAN	MEHMET	HIDRI	70203874	12/7/2016	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_1514						
229	HANE	AHMET	KOLOSHI	70208029	13/06/2017	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_1649						
230	SHKUMBIN	ADEM	ISUFAJ	70203855	11/7/2016	SHTETER
231	NAIM	VULLNET	DOBRUSHI	70206324	22/12/2016	SHTETER
QARKU_TIRANE, ZVRPP_TIRANE, ZONA KADASTRALE_3992						
232	LUFTAR	LLESH	ARAPI	70202953	29/04/2016	SHTETER
233	SERVET	FERUK	NELI	70203666	29/06/2016	SHTETER
234	KUJTIM	HYSNI	CARA	70203546	23/06/2016	SHTETER
235	BESIM,ZAIM	ZAIM,MUST	KASTRATI	70203848	11/7/2016	SHTETER
236	REHAN	HAZIR	ISLAMAJ	70205769	18/11/2016	SHTETER
237	BESIM	SALI	MENA	70202052	13/02/2016	SHTETER
DREJTORIA E ALUZIONI-t_KAVAJE						
238	VELI	RESHIT	SKENDERI	Nr.7002692,	dt. 14.12.2016	Shteterore
	RESHIT	ALI	SKENDERI			
239	ALFRED	MYFTAR	TAFA	Nr.7002704,	dt.	Shteterore
240	MUHREDIN	BAJRAM	MYFTARLL	Nr.7008062,	dt.	Shteterore
241	KASTRIOT	NAMIR	DEMA	Nr.7007051,	dt.	Shteterore
242	FREDERIK	NAUM	BOJA	Nr.7006837,	dt. 19.01.2018	Shteterore
	MAJLINDA	ASPI	BOJA			
243	PANDI	PASK	TRIFI	Nr.7006851,	dt.	Shteterore
244	JANI	THOMA	BALLIU	Nr.7006843,	dt.	Shteterore
245	MUHAMED	PETRIT	DMNI	Nr.7006831,	dt.	Shteterore
246	FEHMI	LIMAN	MUSTA	Nr.7006818,	dt. 28.01.2018	Shteterore
	Harun,Nafije	REXHEP	MUSTA			
Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						

Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Pjesa takuese në parcelë
	Emër	Atësi	Mbiemri	Leja e legalizimit		Pjesa juridike (pronesia)	
				Numer	Date		
1	2	3	4	5	6	7	8
247	SAMI	VAHID	CARA	Nr.7008058,	dt.	Shtetërore	
248	VASIP	HAMDI	TALLUSHI	Nr.7006850,	dt. 25.01.2018	Shtetërore	
249	AGRON	HASAN	MISIRI	Nr.7006942,	dt. 23.03.2018	Shtetërore	
DREJTORIA E ALUIZINI-T LUSHNJE							
QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8571, ZVRPP LUSHNJE							
250	GANI	OSMAN	SHEHU	NR.1000000288,		SHTETER	
251	MERUSHE	MURAT	MUÇA			SHTETER ORE	181.78
	ANISA	ISA	MUÇA	NR.1000000190,			
	ERVIN	ISA	MUÇA	DT.02.08.2017			
252	HAMIDE	MEHMET	RUÇI	NR.1000000478,		SHTETER	
253	ISUF	SKENDER	GJYLA	NR.1000000474,		SHTETER	
254	ANDREA	FERDINAND	LEKA	NR.1000000193,		SHTETER	
255	LULZIM	ISLAM	SARACI	NR.1000000506		SHTETER	
256	FATOS	AZIS	BANI	NR.1000000361,		SHTETER	
257	ARDIAN	KAMBER	SEFA	NR.1000000164,		SHTETER	
258	KUJTIM	MYSLIM	LULJA	NR.1000000073,		SHTETER	
259	JANI	ILUA	MAVROMA	NR.1000000083,		SHTETER	
260	ZUA	AVNI	SINANI	NR.1000000012,		SHTETER	
261	NEVRUS	TOMORR	SALIASI	NR.1000000144,		SHTETER	
262	SOKOL	BEXHET	DEMO	NR.1000000120,		SHTETER	
263	HAXHI	BRAHIM	MARKU	NR.1000000114,		SHTETER ORE	
	ILIR	BRAHIM	MARKU	DT.13.06.2017			
264	SKENDER	NAZIF	MERKAJ	NR.1000000117,		SHTETER	
265	NEIM	FERIT	KASHARI	NR.1000000405,		SHTETER	
266	ANASTAS	REXHEP	MARKU	NR.1000000410,		SHTETER	
267	LIRI	NUREDIN	MURATI			SHTETER ORE	
	SAMI	ARTAN	MURATI	NR.1000000429,			
	METHAT	ARTAN	MURATI	DT.31.10.2017			
268	ILIR	AZEM	LUSHKA	NR.1000000653,		SHTETER	
269	LEFTER	KAPLLAN	CANKA	NR.1000000655,		SHTETER	
DREJTORIA E ALUIZINI-T SHKODER							
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8594							
270	ZAMIR	QEMAL	LLAZANI	101850	15.05.2017	SHTETER	
271	ZEF	NDUE	HASANI	101425	27.04.2017	SHTETER	
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8593							
272	ARBEN	LAZER	GJERGJI	94167	13.01.2016	SHTETER	
Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Pjesa takuese në parcelë
	Emër	Atësi	Mbiemri	Leja e legalizimit		Pjesa juridike (pronesia)	
				Numer	Date		
1	2	3	4	5	6	7	8
273	ARDJAN	GJON	FIRZA	95592	21.07.2016	SHTETER	
274	FAIK	EMIN	PIRI	100657	17.02.2017	SHTET	
275	GEGE	PAL	DOÇAJ	96194	26.08.2016	SHTET	
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8592							
276	SABAHEJEDIN	RIFAT	HEBOVI	101963	15.06.2017	SHTETER	
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8597							
277	ELJAZ	ALI	ALUSHI	19071	22.02.2017	SHTETER	
278	PJERIN	LAZER	LAZRI	95945	19.12.2016	SHTETER	
QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 1495							
279	SIRJAN	HASIM	ALUA	102156	19.01.2018	TE TE TRETËV	
DREJTORIA E ALUIZINI-T TIRANE 2							
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8140							
280	EDISON	FERIK	SELMANI	119687	17.11.2017	Shtetërore (28.4 m ²) E të tretëve (26.9 m ²)	
	NAIM	SHEFQET	DOMI	119688	17.11.2017		
	FERIK	ARIF	SELMANI	119689	17.11.2017		
	ARTUR	RESHAT	GUMBAR DHI	119690	17.11.2017		
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8160							
281	SKENDER	BAKI	BEKTESHI	119384	28.08.2017	Shtetërore (50.52 m ²) E të tretëve (12.68 m ²)	
	ARBEN	SPIRO	MEHILLI	119383	28.08.2017		
	ARMIS	FAHRI	MEKA	119382	28.08.2017		
	LEFTERI	TODI	BOZO	118908	08.05.2017		
	QIRJAKO	PASKAL	KURETA	118909	08.05.2017		
282	AVJON	ISLAM	DORZI	118929	11.05.2017	Shtetërore (26.2 m ²) E të tretëve (35.7	
	AHTERE	NEKI	XHXHA	119273	14.08.2017		

Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Pjesa takuese në parcelë
	Emër	Atësi	Mbiemri	Leja e legalizimit		Pjesa juridike (pronesia)	
				Numer	Date		
1	2	3	4	5	6	7	8
283	TATJANA	XHELAL	SINAJ	119215	24.07.2017	m ²)	
	HYQMET	HYQMET	ALIBESI	119438	11.09.2017		
	QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8350						
284	ANASTASIA	VANGJEL	PITE			Shtetërore (7.0 m ²) E të tretëve (6.1 m ² +5.4 m ²)	
	FLORIAN	DHAME	PITE	119624	27.10.2017		
	MIRSA	DHAME	PITE	118877	26.04.2017		
	LAURET	NIKOLLE	LLESHAJ	119043	02.06.2017		
	KUJTIM	BEDRI	BEQO	119394	29.08.2017		
	SHPETIM	SHABAN	IDRIZI				
	NATASHA	MYRTEZA	IDRIZI				
	MARA	IVAN	MERXHUSHI	119395	29.08.2017		
	VALERIA	HASAN	MERXHUSHI				
	TEFTA	MYZAFER	TUSHI				
285	ENGJELL	SHAHIN	FEJZAJ	119245	31.07.2017		
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180							
285	SHEFIT	ADEM	TUSHA	119580	13.10.2017	Shtetërore (6.6 m ²) E të tretëve (22.2 m ²)	
	SHEFIT	ADEM	TUSHA				
	DORIAN	TOMORR	DEMETJA	119579	13.10.2017		
	FATOS	BAKI	YZEIRI	119490	26.09.2017		
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8150							
286	SHTJEFEN	RROK	ZOJZI	119238	28.07.2017	Shtetërore	
	ENDRI	NIKOLLA	BERATI	119203	18.07.2017		
	MUHARREM	ELMAZ	DEZHGIU	119204	18.07.2017		
	NDUE	ZEF	TOMA	119205	18.07.2017		
Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Pjesa takuese në parcelë
	Emër	Atësi	Mbiemri	Leja e legalizimit		Pjesa juridike (pronesia)	
				Numer	Date		
1	2	3	4	5	6	7	8
287	HYSEJ	OSMEN	KORDHA	119258	02.08.2017		
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8310							
287	SHPETIM	ZYBER	LILA	118939	15.05.2017	Shtetërore	
	GEZIM	ISA	GUÇE	118938	15.05.2017		
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230							
288	BILBIL	SABRI	XHAFAJ	119142	22.06.2017	Shtetërore	
	ALBERT	SEJDO	KAMBERAJ	119143	22.06.2017		
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8120							
289	AGRON	GJYSHO	SHEHU	118754	07.04.2017	Shtetërore	
	HATXHE	HAMIT	LIXSALA	119248	31.07.2017		
	AGRON	GJYSHO	SHEHU	118754	07.04.2017		
	HATXHE	HAMIT	LIXSALA	119248	31.07.2017		
290	HATXHE	HAMIT	LIXSALA	119249	31.07.2017	Shtetërore	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8150							
291	ASTRIT	MEHMET	AZIJAZ	118866	25.04.2017	Shtetërore (4.55 m ²) E të tretëve (6.15 m ²)	
	MARJETA	SEFER	DOBI				
	LUAN	SUBI	DOBI	119399	29.08.2017		
	VEBI	NURI	VARROSI	118867	25.04.2017		
ARDIAN	THOFAN	BEZHANI	118865	25.04.2017			
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8270							
292	JONDA	MAKSIM	BAJRAKTA	119683	16.11.2017	Shtetërore	
	EDLIRA	KUJTIM	LLOHA	119843	22.02.2018		
	MAKSIM	XHEVDET	LLOKA	119548	06.10.2017		
	HAMIDE	ZENEL	BASHAJ	118926	11.05.2017		
	ABEDIN	HEKURAN	KALEMI	119231	28.07.2017		
	VELI	SELAMI	MUSTAFAR	118927	11.05.2017		
	SOKRAT	MEÇO	AMATAJ	118928	11.05.2017		
	GEZIM	KOSTANDI	SHARRA	119691	20.11.2017		
	SPIRO	THIMI	THEMELI				
	MIMOZA	RAKIP	THEMELI	119653	08.11.2017		
LILJAN	ELJAZ	PICOKU	119678	16.11.2017			
PAQIZE	QAZIM	PICOKU					
SOSE	SABRI	ISLAMAJ					
293	LUMTURI	NAMIK	VAKO				
Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar						Pjesa takuese në parcelë
	Emër	Atësi	Mbiemri	Leja e legalizimit		Pjesa juridike (pronesia)	
				Numer	Date		
1	2	3	4	5	6	7	8

Opinion

i Ditës

"Zilja e fundit" për integrimin në BE

Nga Brunello Rosa

(vijon nga faqja 1)

...Bankës Qendrore Evropiane, si dhe përfaqësuesi i lartë për çështjet e jashtme dhe sigurisë.

Rritja e partive populiste në një numër të vendeve të BE-së, që janë në gjendje të ndikojnë në vendimet e ardhshme politike, dhe zgjedhja e personelit në krye të këtyre organizatave, do të thotë se këto zgjedhjet nuk do të jenë dhe aq të parëndësishme. Ato do të përcaktojnë të ardhmen e procesit të integritimit evropian, në kohën e ngadalësimit apo edhe recesionit ekonomik.

Sipas sondazheve më të fundit, të dyja partitë që kanë mbizotëruar prej vitësh në Parlamentin Evropian - Partia Popullore Evropiane (PPE), dhe Partia e Socialistëve dhe Demokratëve, do të fitojnë më pak vende, duke e bërë të pamundur formimin e koalicionin tradicional të PPE - S & D, që ka udhëhequr Evropën gjatë dekadave të fundit.

Partitë e krahut të djathtë dhe ato nacional-populiste, do të kenë shanse të marrin më shumë deputetë. Synimi i tyre, është t'i ofrojnë PPE-së së dobësuar mundësinë e një aleançe paszgjedhore. Kjo do të ishte një pasqyrë në nivel evropian, të marrëveshjeve mes koalicioneve qeverisëse tashmë në pushtet, në vende si Austria, ku kancelari Sebastian Kurc, partia e të cilit është anëtarë e PPE-së, qeveris me Hajnc-Kristian Strahe, të Partisë së Lirisë të ekstremist të djathtë.

Ura lidhëse midis PPE-së dhe këtyre grupimeve nacionalisto-populiste, do të ishin ato anëtarë të PPE-së, si Fidesz, partia e kryeministrit hungarez Viktor Orban, që natyrisht do t'i përkiste më shumë grupimit të dytë se sa të parit. Në një shenjë të qartë të kësaj tendence, PPE ka zgjedhur Manfred Weber si kandidat për të drejtuar Komisionin e KE.

Weber, kreu i grupit parlamentar të PPE-së në Strasburg, është anëtar i Unionit Kristian Social, partia bavareze simotër e Unionit Kristian Demokrat gjerman, që mban shpesh qëndrimet të krahut të djathtë, veçanërisht mbi emigracionin. Në të shkuarën, Weber ka shprehur keqardhje mbi pikëpamjet e udhëheqësve nacionalo-populistë, si Mateo Salvini në Itali, dhe Orban në Hungari.

Një aleançë e tillë midis PPE-së dhe populistëve nacionalistë, do të synonte të ngadalësonte aspektet e procesit të integritimit evropian, duke favorizuar rikthimin e pjesshëm të sovranitetit në nivel kombëtar për çështje të caktuara, përfshirë emigracionin, kontrollin e kufijve dhe politikat fiskale.

Por, edhe nëse populistët nacionalistë, do të dalin shumë mire në këto zgjedhje, humbja e pritshme e disa mandateve nga PPE-ja, do të thotë që një koalicion midis dy blloqeve, nuk do të kishte numrat e mjaftueshëm, për të formuar një shumicë të qëndrueshme në Par-

Ndërsa vëmendja në Britaninë e Madhe, është e fokusuar kryesisht mbi mënyrën se si do të largohet nga Bashkimi Evropian, në pjesën tjetër të kontinentit, ngjarja kryesore e këtij viti do të jetë, zgjedhjet për Parlamentin Evropian në datat 23-26 maj. Pas ripërtëritjes së PE-së, reduktuar në 705 deputetë nga largimi i mundshëm i Britanisë - krerët e institucioneve dhe organizatave të tjera do të riorganizohen sipas një loje kush e zë i pari karrigen.



lamentin Evropian.

Dy faktorë të tjerë, e frenojnë këtë koalicion të sapolindur. Derisa Angela Merkel të jetë kancelare e Gjermanisë, ajo nuk ka gjasa të favorizojë një ndryshim të tillë të menjëhershëm të aleançave. Njëherazi, sulmet shumë publike të Orban ndaj Presidentit të Komisionit të BE-së, Junker, kanë imponuar pezullimin e bisedimeve midis PPE-së dhe populistëve nacionalistë.

Për pasojë, PPE mund të mbetet ndoshta në një formë të zgjeruar, ar të koalicionit të madh, duke shtuar grupimin Aleanca e Liberale dhe Demokratëve, bashkë me deputetët francezë të zgjedhur nën logon e partisë së Emanuel, dhe ndoshta të Gjëlberëve, deri tek

grupi i Socialistëve dhe Demokratëve.

Katër partitë pritet të kontrollojnë së bashku më shumë se 60 për qind të vendeve në Parlamentin e ardhshëm Evropian. Ky koalicion i përbërë i establishmentit politik, do të menaxhojë emërimin e liderëve të BE-së, duke marrë përgjegjësinë për trajtimin e çfarëdolloj krize që prek BE-në gjatë 5 viteve të ardhshme. Dhe duke e bërë këtë, ata mund të shohin se po mbjellin "farat" e krizës së ardhshme të BE-së.

Politikanët e establishmentit, mund të marrin frymë të lehtësuar nëse formohet një koalicion i tillë i madh, por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ata e kanë ndalur dallgën populiste. Në vitin 2017, Makron u zgjodh me 65 % të

votave, përkundërt Marin Lë Pen, që është prototipi i nacionalist-populistëve evropiane.

Por, nga atëherë popullariteti i tij ka rënë ndjeshëm, ndërsa Le Pen ka fituar terren, gjë që mund të rrisë shanset për zgjedhjen e saj të presidentit në vitin 2022, duke hedhur idenë që Franca të braktisë eurozonën, dhe duke ndryshuar emrin e partisë së saj nga Fronti Kombëtar në Tubimi Kombëtar.

Rasti i Francës, tregon se si koha po punon në favor të populistëve nacionalistë. Ata kanë thjeshtë nevojë të presin shansin e duhur për të marrë pushtet. Ndërkohë, populistët po i shtojnë partitë e establishmentit t'i bashkohen aleançave të panatyrshme dhe kon-

tradiktore.

Dhe ky shans mund të vijë me rënien e ardhshme ekonomike, që pritet gjerësisht të ndodhë në vitet 2020-2021. Në atë pike, do të jetë e lehtë që populistët nacionalistë të fajësojnë partitë e establishmentit jo vetëm për krijimin e krizës financiare globale të vitit 2008, por edhe për përgjegjësinë për zhytjen e vendit në një katastrofë ekonomike.

Ky do të jetë momenti kur populistët nacionalistë do t'i bëjnë PPE-së ofertën: thojni lamtumirë socialistëve, liberalëve dhe të gjëlberëve, dhe formojmë bashkë një koalicion për të "shpëtuar" Evropën. Kjo mund të jetë një ofertë që PPE nuk mund ta refuzojë, pasi do t'i duket si mënyra e vetme për të dalë nga paraliza, me të cilën do të përballlet unioni gjatë 2 apo 3 viteve të ardhshme.

Komisioni i ardhshëm i BE-së, nuk ka gjasa të jetë plotësisht operacional para vitit 2020, dhe me zgjedhjet në Gjermani në vitin 2021, dhe ato në Francë në 2022-in, çdo vendim domethënës për të ardhmen e Europës - krijimi i unionit të tregjeve bankare dhe kapitaleve, mbi politikën e migracionit etj. - nuk pritet të merret para qershorit 2022.

Prandaj, ata që shpresojnë se një krizë tjetër do të ofrojë një shtysë për integrimin e mëtejshëm, mund të jetë duke bërë një supozim të gabuar. Realiteti është se kohezioni evropian, është aq shumë i dobësuar nga krizat e një-pasnëshme, sa që nuk mund të mbijetojë një krizë tjetër.

Në gjithë këtë situatë, vendimtare do të jetë pozicioni i Gjermanisë. Luftërat tregtare të Donald Trumpit, dhe ndërprerja e zinxhirëve të furnizimit ndërkombehtar, po e godasin ekonominë gjermane. Logjikisht, këto ngjarje duhet të sugjerojnë një rishikim të modelit ekonomik në Gjermani.

Kjo do të kërkonte që gjermanët të vendosnin në tryezë burimet e nevojshme financiare, për të transformuar si BE-në ashtu edhe eurozonën. Një ekonomi e ringjallur evropiane, do të zvoqelonte tërheqjen ndaj partive nacional-populiste. Por a do të ndodhë kjo?

Duke pasur parasysh mosbesimin që ekziston mes Gjermanisë dhe vendeve periferike të eurozonës - si Italia, Greqia, Qiproja dhe Malta - duhet të ketë dyshime të forta se kjo do të ndodhë. Dhe kjo do ta lërë Evropën të pambrojtur përballë populistëve.

Gazeta Express
"Chattam House" - Bota.al


Opinion i Ditës

Pakti i munguar për punën

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...me rezultate të larta (të quajtur studentë të ekselencës) nisjen e punës pa konkurs në Administratën e Përgjithshme Tatimore të vendit. Pak, por është diçka. Po për 1.4 milionë të punësuarit në shtet dhe në privat (duke përfshirë të vetëpunësuarit), a mund t'ju ofrojë diçka kjo qeveri? Mos duhet edhe ata të ngrihen në greva dhe protesta, që qeveria të mendojë një pakt edhe për ta? Vetëm gjatë vitit 2018, 27 punonjës kanë humbur jetën në vendin e punës. Shumica, për shkak të kushteve të pasigurta të punës. Ndërkohë, mijëra të tjerë punojnë me orë të zgjatura, duke mos u paguar për orët shtesë. Punuan 30 mijë punëtorë edhe në ditën e 1 majit, por askush nuk u dha pagesë shtesë për punë në një ditë pushimi. Askush nuk proteston masivisht për paga që nuk rriten prej vitesh me radhë. Paga minimale mbetet më e ulët në rajonin tonë (26 mijë lekë ose 212 euro). Ndërkohë, punësimi i të miturve dhe ai informal vazhdojnë të mbeten në nivele shqetësuese. Dialogu social, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, ndodhet në nivelin më të ulët në të gjithë Europën. Baras me atë të Moldavisë. Janë me dhjetëra mijëra punëtorët që punojnë pa gëzuar pushimin javor, festat zyrtare dhe pushimet vjetore. Që nuk marrin pagesa për paafësi të përkohshme në punë dhe mbrojtje në rast të aksidenteve në punë. Siguria dhe shëndeti në punë janë lënë jetimë, kumte pa kuptim të një legjislacioni pune (ligji nr. 10237, datë 18 shkurt 2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"), i cili nuk njihet nga punëdhënësi e punëmarrës, e jo më të zbatohet. Strukturat shtetërore që duhet të ndjekin zbatimin e tij, në veçanti Inspektorati Shtetëror i Punës dhe ai Shëndetësor flenë në të gjitha stinët një gjumë dimëror ariu. Askush nuk sheh rritjen e rasteve me sëmundje kronike profesionale, si problemeve kronike të frymëmarrjes, të spondilatrozës, të dhimbjes së kokës, gjymtyrëve dhe problemeve të infeksioneve të lëkurës. Të 1.4 milionë punonjësit shqiptarë e meritojnë një Pakt për Punën, të cilën edhe mund ta iniciojë qeveria, sikurse bëri për studentët. Për ngritjen e këshillave të punëtorëve (nën shembullin e shkëlqyer gjerman). Këto janë struktura që mbikëqyrin zbatimin e kontratave kolektive dhe funksionimin real (jo formal) të këshillave të shëndetit dhe të sigurisë në punë (detyrim ligjor). Janë konsideruar me vlerë të shtuar dhe të pazvëndësueshme edhe në vende si Gjermania e Silovonia, me sindikata të fuqishme që i mbrojnë drejtpërdrejt anëtarët e tyre. Të mendosh sa të domosdoshme që janë këtu tek ne! Kryeministri sapo është kthyer nga shteti ndër më socialët në botë, nga Gjermania. Duhet ta mendojë një pakt edhe për punën. Nëse nuk e mendon, ato pak struktura të vogla, por reale



sindikalistek tek ne (Sindikata e Postë-Telekomit Shqiptar, Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptarë, etj.) duhet t'ia sjellin në mendje. Shtetet sociale të BE-së kanë instaluar bazat ligjore dhe organizative për dialogun social. Nëse duhet të ngjasojmë me to, këtë mund ta japim shumë shpejt si shenje me miratimin e ligjit për këshillat e punëtorëve. Do të ishte një ogur i mirë për vendimin për hapjen e bisedimeve për anëtarësim që e shpresojmë të gjithë të merret këtë vit. Kemi vetëm dy nene të shkëputura për këshillat e punëtorëve, në ligjin "Për Shoqëritë Tregtare". Ka ardhur koha t'i vendosim mirëfilli bazat e dialogut social edhe ne. Këshilli i Punës është një strukturë e fryrë kallpe që nuk vendos përballë njeri-tjetrit përfaqësuesit realë të punëdhënëseve dhe të punëmarrësve tek ne. Ndërsa donatorët për këshillat e punëtorëve i kemi. Janë fondacioni gjerman

Friedrich Ebert dhe fondacioni suedez Olof Palme International Center. Jo rastësisht këto dy struktura të dy ndër shtetet më sociale në botë, shpenzojnë fonde edhe tek ne. Duhet përgatitur ligji për këshillat e punëtorëve. Ato nuk janë për t'u bërë karshillëk sindikatave që kemi (dikush thotë se kemi "sindi-kaka") dhe jo sindikata, duke nënkuptuar dinosauret e bashkimeve sindikaliste që vetëm përfaqësues realë të punëtorëve nuk janë. Në Gjermani si sindikatat edhe këshillat e punonjëseve bashkëpunojnë. Plotësojnë njëra-tjetrën. Një sindikatë e madhe nuk kontrollon dot zbatimin e kontratës kolektive të punës, sigurinë dhe shëndetin në punë, për ndërmarrje të vogla. Prandaj dhe duhen strukturat e zhërvjellëta të këshillave të punëtorëve. Tek ne këshilli mund të vlejë edhe për zbatimin e kontratave individuale të punës, për kompanitë shumë të vogla që kemi. Tek ne lëvizja sindikaliste fle gjumë, ash-

tu e nanuritur mes bashkimeve të vjetra sindikaliste, që u ka ngelur ora. Duhen strukturat të reja e të zhërvjellëta. Këshillat e punonjëseve mund ta luajnë më së miri këtë rol. Mund të sjellin shpresë dhe nevojë reale për bashkim në lëvizjen tonë sindikaliste. Mund të mposhtet frika për humbjen e punës, pse kërkon të drejtat e tua. Në një ndërmarrje private të fasonit, punonjëset që u përpoqën të krijonin një sindikatë u pushuan nga pronari. Sigurisht u gjetën shkaqe të tjera, gjoja mos performanca e duhur në punë. Dhe frika mbizotëron në sektorin shtetëror e privat. Edhe tek ndërmarrjet tona shtetërore, sidomos ato në formën e shoqërive anonime, drejtori sillet si pronar. Ka ardhur koha të ngremë këshillat e punonjëseve. Të installojmë paktin e munguar të punës dhe dialogun e vërtetë social. Për këtë, qeveria duhet të na japë një dorë. Nëse e ka seriozizht me kthimin e shpresës se ky vendi ynë bëhet.

HOROSKOPI

DASHI

Përdorni bujarinë tuaj maksimalisht sot. Kjo do t'ju hapë dyert dhe do t'i bëjë njerëzit t'ju kutojnë në një mënyrë shumë të favorshme. Një investim i pamenduar mirë mund t'ju hapë probleme në të ardhmen.

DEMI

Gjatë kësaj dite do të ndiheni gjithnjë e më i ngadaltë, por për fat të mirë, detyrat që do t'ju duhet të bëni nuk do të kërkojnë shumë energji fizike apo entuziazëm. Merrni ditën me qetësi dhe me kalimin e kohës do të keni energjinë e duhur.

BINJAKET

Diçka emocionuese po ndodh rreth jush sot. Përpiqini ta identifikoni atë dhe të kaloni një kohë të bukur. Në punë do t'ju duhet të punoni më shumë për të arritur objektivat që i keni vënë vetes. Jeni në garë me veten tuaj, me askënd tjetër.

GAFORJA

Nëse e kuptoni se dikush është duke u përpjekur t'ju shkatërrojë nervat sot, bëjini vetes një nder dhe mos reagoni me emocione. Do të jetë një pengë dhe duhur ndaj personave që duan t'ju prishin ditën.

LUANI

Nëse takoni dikë që ju ndryshon mendimin tuaj mbi një temë të caktuar sot, duhet të jeni mirënjohës, por, gjithashtu, duhet të jeni të kujdesshëm që të mos i jepni këtij personi shumë besueshmëri në të ardhmen. Ai ose ajo mund të kërkojë t'ju manipulojë.

VIRGJERESHA

Mos besoni gjithçka që dikush mund t'ju thotë sot. Qëllimi i tij mund të mos jetë ai i duhuri. Sa i përket një raporti dashnor, sot gjërat mund të mos lëvizin me ritmin që do të dëshironit, megjithatë mos u xhitoni.

PESHORJA

Marrëdhëniet janë fokusi juaj sot-edhe pse jo domosdoshmërisht ato romantike. Ka shumë konfuzion në disa prej relacioneve tuaja dhe mund të keni nevojë të punoni për të shkëputur disa nga këto nyje.

AKREPI

Në mënyrë që të jeni i lumtur dhe i shëndetshëm, nevojitet disi më shumë disiplinë dhe rend në jetën tuaj. Laimi i mirë është se ju e dini se cilat janë zgjedhjet e duhura. Uini dhe mendoni se çfarë është e mirë për ju.

SHIGJETARI

Produktiviteti nuk do të jetë një problem për ju sot, kështu që nuk duhet të stresoheni në lidhje me përmbyshjen e afateve. Kjo është një ditë e mrekullueshme për të pasur rezultat në fushat që i keni për zemër.

BRICJAPI

Marrëdhëniet tuaja janë më solide se kurë, përkundër faktit se ka pasur pak konflikte në të kaluarën. Ju nuk duhet të mendoni se njerëzit nuk ju pëlqejnë vetëm sepse ata argumentojnë me ju.

UJORI

Kjo është një ditë e mrekullueshme për të lëvizur përpara idetë tuaja. Përqendrimi i energjisë në ide të avancuara dhe njerëz të sofistikuar do ta kënaskë intelektin tuaj. Gjoja ditë, po provoni tek ju se jeni të aftë për më shumë.

PESHQI

Sot mund të merrni lajme të mira sa i përket punës. Mund të ketë të bëjë me një aplikim të suksesshëm ose me rritje në detyrë. Jini entuziast për çdo zhvillim pozitiv që vjen nga ju sektori, sepse vjen falë përpjekjeve tuaja të vazhdueshme.

PREMIER LIGË

Barazimi 1-1 i Manchester Unitedit me Huddersfieldin e la përfundimisht jashtë Championsit skuadrën e drejtuar nga Ole Gunnar Solskjær, por ky dështim do të shqetësohet me humbjen financiare të "Djajve të Kuq", që e kanë të parashikuar në kontratë uljen drastike të pagës në rast të mos arritjes së këtij objekti



minimal. Shumica e kontratave të "yjeve" të United ka një klauzolë që i shpreh lojtarët të humbasin 25% të pagës së tyre. Paul Pogba, që paguhet 300 000 paund në javë preket më shumë nga ulja e pagës. Francezi do të humbasë 1.8 milionë paund nga paga e tij vjetore. Kjo shumë, në fakt, do t'i jepej bonus futbollistit në rast pjesëmarrjeje në

Manchester United mbetet jashtë Championsit, lojtarët humbasin 50% të pagave

Champions. Pogba nuk është i vetmi lojtar që merr goditje nga reduktimi i të ardhurave. Alexis Sanchez, që ka pagën më të lartë (500 000 paundë në javë), do të humbasë 125 000 paund në javë nëse qëndron në "Old

Trafford". Si Pogba, ashtu edhe Sanchez, janë përfolur për një largim të mundshëm nga United, që sigurisht nxitet edhe nga reduktimi i pagave të tyre për mospjesëmarrjen në Champions.

REDUKTIMI I PAGAVE TE UNITED - 25%

1. Alexis Sanchez (nga 500 në 375 mijë paund)
2. Paul Pogba (nga 300 në 225 mijë paund)
3. Romelu Lukaku (nga 250 në 187 mijë paund)
4. David de Gea (nga 200 në 150 mijë paund)

Fred (nga 175 në 131 mijë paund)

Shqiptarët luanin një derbi mes tyre që vlente një biletë në zonën e lartë të renditjes



Jeton Selimi

Gjimshiti thyen Strakoshën, Atalanta pranë Championsit

Bergamaskët ndërrojnë arenën e gjigantëve

Këtë javë Seria A rezer vonte një përballje direkte mes shqiptarëve si ajo mes Lacios së Tomas Strakoshës dhe Atalantës së Berishës dhe Berat Gjimshitit. Por nëse portieri Berisha e ndoqi të gjithë ndeshjen nga stoli, e kundërta ishte për dy shqiptarët e tjerë që ishin protagonistë. E fitoren 3-1 të bergamaskëve meritë kishte edhe mbrojtësi Berat Gjimshiti, i cili i ndihmuar edhe nga mbrojtësi i kryeqytetasve që kontribuoi në golin e tretë duke mposhtur Strakoshën, i cili nuk mund të bënte asgjë për të evituar golin. Më parë për Atalantën kishte shënuar Zapata dhe Kastanos. Një realizim që vlosi triumfin e bergamaskëve ndërsa Lacio, e cila kishte kaluar e para në avantazh, duket se i ka dhënë fund ëndrrave për një kualifikim në Ligën e Kampionëve. Ndërkohë dy takimet e tjera të Serisë A dhuruan dy barazime spektakolare. Sampdoria barazoi në transfertë 3-3 ndaj Parmës, teksa vëmendjen e mori sulmuesi Kualajrela, i cili shënoi një dygolësh për të shtuar edhe më shumë diferencën në krye të golashënuesve me ndjekësit. Ndërsa Sasuolo barazoi



2-2 shtëpi me Frosinonen. Vlerësimet për shqiptarët Berat Gjimshiti arriti të fitonte derbin e shqiptarëve ndaj

Lacios në "Olimpiko" duke e mundur me rezultatin 1-3. Goli i tretë në këtë takim, mund të quhet padyshim si

merita e Gjimshitit, i cili devijoi me kokë një top nga këndorja, duke detyruar Uollas ta shtyjë në rrjetin e gabuar. Nga ana tjetër, megjithëse ka pësuar 3 gola, Strakosha nuk është fajësuar dhe ka marrë meritë nga mediat italiane për paraqitjen e bërë. Ka qenë pikërisht "Eurosport.it" ajo e cila ka thurur elozhe për dy futbollistët shqiptarë. "Thomas Strakosha 6: Gabon në golin e tretë por shkëlqen me pritjet e tij në fillim të pjesës së dytë duke hequr një gol të sigurt të Ilçiç. Berat Gjimshiti 7: Pa asnjë të metë në mbrojtje dhe ka meritën kryesore në mbylljen e takimit pasi është shkaktoi që Uollas të shënojë autogoli duke i bërë presion. I vëmendshëm dhe i sigurt. Është një mbrojtës i madh", shkruhej në vlerësimin për dy futbollistët.

MOTO GP

Marquez dominon në Jerez dhe rimerr kryesimin

Marc Marquez ringrihet menjëherë. Kampioni në fuqi i botës në Moto Grand Prix dominoi Çmimin e Madh të Jerez de la Frontera, të zhvilluar në Spanjë duke regjistruar suksesin e dytë sezonal dhe duke hedhur pas shpatullave atë rrëzim në Austin. Një sukses i gjithi spanjoll ai në Jerez pasi podiumi u kompletua nga Alex Rins me Suzuki dhe Maverick Vinales me Yamahan. Falë fitores në garën e shtëpisë Marc Marquez mori edhe kryesimin e klasifikimit të përgjithshëm pas 4 garave të para në kuotën e 70 pikëve, 1 më shumë se Alex Rins dhe 3 më tepër se Andrea Dovizioso. Vetëm vendi i 6-të për Valentino Rossi që zhvilloi një garë në malore por e mbylli duke marrë pikë të rëndësishme.

PARTIZANI

Hysen Dedja: Partizani kampion falë Skënder Gegës

Trajneri Hysen Dedja, i ftuar në emisionin e televizionit "News 24", "Sport News Plus", ka analizuar skuadrat e kampionatit shqiptar. Dedja ka bërë një analizë të të gjitha skuadrave dhe është ndalur disi më shumë te Partizani, i vendit të parë. Unë ndalem tek anët teknike të skuadrave. Është një Partizan që kryeson me meritë, edhe pse e nisi me humbje me Skënderbeun. Është një skuadër shumë e motivuar. "Pa i hequr asnjë meritë presidencës, Gega është drejtuesi që e ka sjellë Partizanin këtu. Ai ka mbajtur grupin të lidhur edhe pse nuk mund të menaxhonte forcën fizike të tyre. Asani apo Hoxha kanë luajtur thuajse të gjitha ndeshjet. Është e vështirë të menaxhosh një grup të tillë. Flamurtari dhe Daja me gjithë problemet që kanë ka bërë maksimumin. Gara për në Europë do të jetë shumë e fortë. Teuta ka bërë dy faza shumë të mira të para, por në fazat e fundit, nuk ka bërë mirë. Skënderbeu, pret dënimin nga UEFA dhe me gjithë problemet që ka lufton për Europë. Laçi ka bërë një punë shumë të mirë dhe Starova vazhdon ta bëjë. Në fundin e tabelës, nëse Laçi s'do kishte shënuar në fund do të kishte një luftë të fortë për mbijetesën".

ËSHTË THUAJSE E KRYER

Hysaj do të largohet nga Napoli në fund të sezonit

Eliseid Hysaj do të largohet nga Napoli në fund të sezonit. E sigurt për këtë është prestigjiozja italiane, e cila në numrin e saj të së dielës zbulon se si menaxheri i mbrojtësit shqiptar, ia ka njoftuar këtë vendim klubit. Duke qëndruar në atë që raporton kjo gazetë, Mario Giufredè është takuar me drejtuesit e Napoli për të kërkuar që "klienti" i tij të lejohet për të hyrë në tratativa me skuadrat e tjera në merkaton e verës. Ky ish-të një fundi i pritshëm, sidomos pas dështimit të bisedimeve për rinovimin e kontratës. Po ashtu, që pas uljes në pankinë të Carlo Ancelotti, Hysaj është kthyer në një zgjedhje të dytë. Prej kohësh zërat e merkatos e kanë afruar mbrojtësin kuqezi me Chelsea që drejtohet nga mentori i tij Mauricio Sarri. Ndërkohë, ditët




MBROJTËSI AKUZON

Kahill: Sarri është treguar i padrejtë me mua

Skuadra e Çelsit këtë sezon emëroi në krye të stollit italianin, Mauricio Sarri. Për ish-teknikun e Napoli pritshmëritë ishin të mëdha për vetë futbollin që aplikon trajneri. Megjithatë, sërish skuadra londineze nuk ka siguruar kualifikimin në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm, ndërsa ka pasur në Ligën e Europës ka ecur mirë duke mbërritur në gjysmëfinale. Sigurisht, me ardhjen e Sarrit ka ndryshuar edhe titullarët e skuadrës. Një nga këto është mbrojtësi, Geri Kahill. Britaniku ka humbur vendin e titullarit teksa është aktivizuar vetëm një herë në kampionat dhe 7 herë në të gjitha kompeticionet e këtij sezoni. Në këtë formë, mbrojtësi ka vendosur të largohet sezonin e ardhshëm, por ka shpërthyer ndaj Sarrit për trajtimin nga tekniku italian. "Është treguar i padrejtë si ndaj meje, po ashtu edhe ndaj disa lojtarëve që janë këtu prej shumë kohësh dhe kanë fituar. Nëse nuk luan për 2 ose 3 ndeshje mund edhe të mos japësh shpjegime, por nëse nuk luan prej më shumë ndeshjesh atëherë detyrohesh të japësh shpjegim. Na ka vështirësuar jetën, është treguar i padrejtë. Nuk mund të respektoj dikë që nuk ma kthen respektin", tha Kahill.

Fjalëkryqi (1)



- 34. Rastet pa set.
- 36. Rastisin në krye.
- 37. Fillojnë detyrën.
- 38. Bektashi këngëtarë.
- 39. Andrea aktore.
- 41. Sampras i tenisit.
- 43. Shkroi Korbi (indic).
- 44. Triplet e Trëndafilë me kredi.
- 46. Kilmer aktor.
- 47. Në krye të robotëve.
- 49. Unë dhe ti.
- 50. Një mund të jetë fetar.
- 51. Stephane poet francez

VERTIKAL

- 1. Fillojnë praktikën.
- 2. Britma e Arkimedit.
- 3. Ekstremit në trap.
- 4. Në fund të fundit.
- 5. Janë fjetoret e ushtarëve
- 6. Parker regjisor.
- 7. Vivaldi kompozitor.
- 8. Një shkop për karambol.
- 9. Janë firmat rentiere.
- 10. Një i fundit mbi të gjithë

HORIZONTAL

- 1. Riza aktor.
- 7. Një fjalë si hiç.
- 11. Një mund të jetë diplomatik.
- 12. Premtun të bëhet as.
- 14. Janë felin... të zinj.
- 16. Ami i Maupassant.
- 18. Heroi i Emilio Salgarit.
- 19. Qe anarkisti i famshëm rus
- 21. Një mungesë gjaku.
- 22. Susanna shkriktare
- 23. Të parat në cilësi.
- 25. Mbyllin një shtëpi.
- 26. Mbeten në fund.
- 27. Qendër në kaos.
- 28. Ka brrirë piktoreskë një i tillë
- 30. Inicialet e Camus.
- 31. Motra... e Kolë Idromenos
- 33. Një konfuzion total.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Një doktor... i Fritz Lang
- 6. U paraprinë hoteleve.
- 11. Kush nuk ka... nuk ha
- 13. Eshhtë djall
- 14. Një mund të ketë i rrallë.
- 15. Ishin perëndi të Samotrakias.
- 17. Institucione Botuese Autonome.
- 18. Eshhtë infeksion në bark
- 20. Fundi i një samurai.
- 21. Një markë kafeje.
- 22. Mbyllin një hark.
- 23. Mund të jetë emërore.
- 25. Ishte muzikanti që nuk përsriste.
- 28. Në krye të avokatëve.
- 29. Qerre pa qe.
- 30. Një pjesë e adoleshentëve.
- 32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.

VERTIKAL


- 1. James, armiku i Sherlock Holmes.
- 2. Eshhtë edhe ajo saudite.
- 3. Imami aktore
- 4. I kanë çift turket.
- 5. Inicialet e Seagal aktor.
- 6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
- 7. Në fund të lutjes.
- 8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
- 9. Mbeten në fund.
- 10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
- 12. Conan ai i Schwarzenegger.
- 13. Gjysmë ditari.
- 15. Mario, që qe bomber argjentinas.
- 16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
- 18. Në hyrje të pistës.
- 19. Një numër... femrash.
- 21. Eshhtë qyteti i Besës
- 24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- 26. Njëlloj për latinët.
- 27. Mund të bëjnë stil të lirë.
- 31. Damon aktor.
- 33. Eshhtë pije e jona.
- 34. Në krye të noterëve.
- 36. Film i Robert Altman.
- 38. Skuadra merengue.
- 39. Një pjesë e hasmërisë.
- 40. Rrallë është përgjysmë.
- 42. Nisur pa kufij.
- 45. Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			9					8
	3		1					9
4	5			3			6	7
							8	5
	1		4				3	
								2
		9	8					
	2		7					
				6	5			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	4	5	6	9	8	7	1	2
6	9	7	2	5	1	4	8	3
8	1	2	3	7	4	5	6	9
2	7	8	4	3	5	6	9	1
1	3	4	9	6	2	8	5	7
5	6	9	8	1	7	2	3	4
4	8	1	5	2	3	9	7	6
9	5	3	7	4	6	1	2	8
7	2	6	1	8	9	3	4	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Kur "qan" një ikonë bizantine, të gjithë nxitojnë ti afrohen asaj. Pyes veten se sa e bëjë të njëjten gjë kur qan një njeri?

- Nëse ju gjithmonë thoni të vërtetën, nuk keni nevojë të mbani mend atë që keni thënë.

- Liria e një personi duhet të arrijë deri aty sa që mos të shkeli lirinë e të tjerëve.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2	1	11	2	7	M	I	K	E	K	M	S	E			
4	9	12	4	11	2	14	13	15	8	2	7	E	K	A	R	O	M	A	K	E	T	
1	12	4	2	12	4	11	6	1	8	2	7	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
4	11	2	5	10	3	1	15	12	2	7	14	M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
7	4	12	5	10	3	4	6	1	7	2	12	P	A	S	A	N	I	K	T	S		
3	12	2	5	10	3	1	14	4	6	1	12	E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
4	12	2	5	1	7	2	12	11	4	3	7	R	E	T	E	E	I	R	A	N	I	
7	10	6	10	14	2	8	12	10	7	4	3	I	T	R	B	L	A	K	E	L		
12	11	1	9	4	12	6	8	15	8	8	14	M	I	A	R	E	D	E	K	I		
1	12	12	15	12	15	1	12	1	14	14	14	E	M	E	T	A	L	E	I	S		
7	2	14	4	12	7	K	H	O	P	S	H	T	E	K	E	M	K	U	M	T		
4	12	1	7	9	4	7	9	4	11	4	12	M	O	R	A	V	I	A	M	A	E	

Thënie të mençura

- Nëse ti bën një gabim, pranoje atë.
- Nëse nuk e pranon, sapo bërë një të dytë.
- Arsyeja se pse njerëzit ta marrin mirësinë për dobësi, është se ti je duke i'u dhënë shumë, më shumë seç meritojnë.
- Gabimi më i madh për ne, është të pranojmë një gabim që nuk e kemi bërë.
- I talentuari bën atë që mundet. Gjeniu bën atë që duhet.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

AR K A A S T R O A M A
 D I A N A H E M I R A T E
 A T L A N T I K E O T L S
 P E I T A R I F A T L E
 T T I P O L I T I K A N E T
 K E N E T A O R A R
 P A U L I N R R I
 A K E G O T A A D D I M
 R U M U N E K I E R A T
 E T J I T I E R I A M A N
 T E I G O R D I A N E
 I N T A R O M A T I T

FJALËKRYQI (2)

P A B M E L E R G O
 R K U P A E M I R A T E
 O H A R A D A R O M A T E
 S T A D I U M E T A P E L
 S T A D I U M E T A P E L
 D I K A S T E R E R U E
 K E N T N G O P J E V
 K A T I A S I E S E R
 A R N I O L A I R
 M A S S I M O Z A N O R E
 A M A N A N N A N N
 T T E R R E N I E I N E

